

Date Printed: 12/30/2008

JTS Box Number: IFES_14

Tab Number: 11

Document Title: MODEL LAWS FOR THE ELECTION OF
COUNCILLORS; REPRESENTATIVES AND

Document Date: 1999

Document Country: MOT

Document Language: ALB

IFES ID: EL00034



* E B 8 3 1 C 6 2 - 0 4 9 8 - 4 4 9 0 - B 4 0 3 - 4 4 2 3 1 4 4 8 5 1 8 C *



MODELET E LIGJEVE

Ligji për zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve

Ligji për regjistrat e zgjedhësve

Ligji për financimin e organizatave politike

International Foundation for Election Systems
Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Elektorale



PËRMBAJTJA

SHËNIME HYRËSE3
LIGJI PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLTARËVE DHE TË DEPUTETËVE	5
I - DISPOZITAT THEMELORE	5
II - PROCEDURA DHE ORGANET PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE	7
1. SHPALLJA E ZGJEDHJEVE	7
2. ORGANET PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE	8
1) Dispozita të përbashkëta	8
2) Komisionet e zgjedhjeve	11
3) Këshilli i zgjedhjeve	17
3. PROPZIMI DHE PËRCAKTIMI I LISTAVE TË ZGJEDHËSVE	18
1) Kandidatura dhe emërtimi i listës së zgjedhësve	18
2) Përcaktimi dhe shpallja e listës së zgjedhësve	19
3) Lista përbledhëse e zgjedhësve	21
4. PREZENTIMI I PARAQITËSVE TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE DHE I ANDIDATËVE NGA LISTAT E ZGJEDHËSVE	22
5. MBAJTJA E ZGJEDHJEVE	26
1) Qendra e votimit	26
2) Votimi	28
3) Përcaktimi i rezultateve të votimit	32
4) Mbrojtja e së drejtës së votimit	33
6. NDARJA E MANDATEVE DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE	36
1) Ndara e mandateve	36
2) Shpallja e rezultateve të zgjedhjeve	37
3) Zgjedhjet e përsëritura	38
III - SHPENZIMET E MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE DHE TË PROPAGANDËS ELEKTORALE	39
IV - KOHËZGJATJA DHE PUSHIMI I MANDATIT	39
1. KOHËZGJATJA E MANDATIT	39
2. PUSHIMI I MANDATIT	40
3. PLOTËSIMI I VENDEVE TË ZBRAZËTA TË KËSHILLTARËVE DHE TË DEPUTETËVE	41
V - DISPOZITAT NDËSHKIMORE	41
VI - DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT	43
LIGJI PËR REGJISTRAT E ZGJEDHËSVE44
LIGJI PËR FINANCIMIN E ORGANIZATAVE POLITIKE	51

MODELET I PËRPUNUAN:

EKIPI I EKSPERTËVE (PROFESIONAL)

Dr.Veselin PAVIQEVIQ, udhëheqës
Slobodan DRAGOVIQ, anëtar
Lilana RADONJIQ, anëtar
Radmila SHTURANOVIQ, anëtar
Predrag VULIKIQ, anëtar

KËSHILLTARË

Prof. Dr. Vladimir GOATI
Prof. Dr. Vesna RAKIQ-VODINELIQ

Këshilltarë dhe bashkëpunëtorë të IFES-it, zyra në Podgoricë

Tom PARKINS, shef i misionit
Catherine BARNES
Aleksandra LEVADITIS
Çedomir FLEGO
Daniel BLESSINGTON
Ana DRAKIQ

PËRKTHYES

Fran GJOKAJ

LEKTOR

Nikollë CAMAJ

Pergaditja për shtyp

Aleksandar DLABAÇ, adlabac@cg.yu

U SHTYP NË

OBOD – Cetinje, Shkurt, 1999.

SHËNIME HYRËSE

Fondacioni Ndërkombëtar për Sistemet Elektorale (IFES) erdhi për herë të parë në Mal të Zi në nëntor të vitit 1997. Gjatë qendrimit trejavor përfaqësuesit e Fondacionit realizuan takime të shumta me përfaqësuesit më të lartë të organeve shtetërore, institucioneve, themelatave dhe organizatave politike. Duke hasur gjithkund në mirëkuptim dhe në gatishmëri reciproke për forma konkrete të bashkëpunimit me qëllim të përparimit të procesit të demokratizimit të institucionit të zgjedhjeve, ka lindur ideja që IFES-i të qëndrojë për një kohë më të gjatë në Mal të Zi. Ideja filloj të realizohet në fillim të prillit të vitit 1998 me hapjen e zyrës së IFES-it në Podgoricë.

Detyra e parë e IFES-it në Mal të Zi ishte dhënia e ndihmës teknike organeve për mbajtjen e zgjedhjeve dhe pjesëmarrësve të tjerë të procesit elektoral në prag të zgjedhjeve parlamentare të mbajtura me 31 maj të vitit 1998. Duke u nisur nga format dhe mënyrat e realizimit të bashkëpunimit të përcaktuara që më parë, IFES-i në bazë të rregullativës ligjore pozitive ka shtypur doracakë për këshillat e zgjedhjeve dhe për kandidatët për deputetë, përkatesisht për këshilltarë. Njëkohësisht ushtrimet praktike, në mënyrë direkte apo indirekte i kanë kaluar 12.000 anëtarë të këshillave të zgjedhjeve dhe të komisioneve të zgjedhjeve. Poashtu me qëllim të popullarizimit të zgjedhjeve dhe të nxitjes së zgjedhësve që në numër sa më të madh të marrin pjesë në to, IFES-i ka pergaditur material adekuat propagandistik. Përveç pllakatave dhe pamfleteve, të shtypura në më shumë se 10.000 kopje, janë punuar edhe disa spote për televizion dhe radio të emetuara në terminet qendrore gjatë kohës së fushatës paraelektorale.

Pas mbajtjes së zgjedhjeve ekspertët e IFES-it, përveç vlerësimit për vetë securinë dhe cilësinë e procesit të zgjedhjeve, kan hartuar edhe analizën kritike të rregullativës elektorale në bazë të së cilës janë mbajtur zgjedhjet e majit. Në atë dokument, i cili u është shpërndarë të gjithë pjesëmarrësve në zgjedhjet e mbajtura, janë veçuar ato sfera, përkatesisht segmente të legjislativës elektorale të cilat, sipas mendimit të analistikëve, do të mundëshin dhe do të duhej të pësojnë ndryshime me qellim të demokratizimit të mëtejmë të sistemit elektoral në Mal të Zi. Fjala është faktikisht për nevojën që në masën e mundëshme maksimale në

këtë moment të kontribuohet në përsosjen e sistemit elektoral ekzistues me qëllim të paanësisë, hapshmërisë, dhe efektivitetit të tij politik.

Duke hasur edhe në këtë rast në qendrim dashamirës të përfaqësuesëve më të lartë te shtetit të Malit të Zi dhe të përfaqësuesve të organizatave të tij politike dhe pas marres së lejes nga fondacioni USAID, pran zyrës së IFES-it në fillim të tetorit të vitit 1998 u formua ekipi profesional për hartimin e modeleve të ligjeve që janë prezantuara në këtë publikim. Natyrisht IFES-i dhe ekipi i tij profesional janë të vetëdishëm për faktin se zgjedhjet janë proces dinamik për ç'arsye ligjet dhe praktika në bazë të së cilave mbahen zgjedhjet detyrimisht i shtrohen modernizimit të vazhdueshëm.

MODEL I LIGJIT PËR ZGJEDHJEN E KËSHILLTARËVE DHE TË DEPUTETËVE

I - DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen mënyra dhe procedura e zgjedhjes së këshilltarëve në kuvendin e komunës, të kryeqendrës dhe të kryeqytetit dhe të deputetëve në Kuvendin e Republikës së Malit të Zi (në tekstin e mëtejmë: këshilltarët dhe deputetët), mënyra dhe procedura e realizimit dhe e mbrojtjes së të drejtës së votimit të qytetarëve në procedurën e zgjedhjes së këshilltarëve dhe të deputetëve, si dhe kushtet dhe mënyra e pushimit të mandatit të këshilltarëve dhe të deputetëve.

Neni 2

E drejtë e votimit, në vështrim të këtij ligji, është e drejta e qytetarit: të zgjedhë dhe për t'u zgjedhur; të kandidojë dhe të kandidohet; t'u parashtrojë publikisht pyetje paraqitesve të listave të zgjedhësve dhe të informohet saktësisht, plotësisht dhe në kohë mbi programet dhe aktivitetet e tyre; të vendosë për listat e paraqitura të zgjedhësve, si dhe të realizojë të drejta të tjera në procesin e zgjedhjeve, në përputhje me këtë ligj.

Neni 3

Qytetarët zgjedhin, me vota të fshehta, këshilltarët dhe deputetët në bazë të së drejtës së përgjithshme dhe të barabartë të votimit, në zgjedhjet e lira dhe të drejtpërdrejta, sipas mënyrës dhe procedurës së përcaktuar me këtë ligj.

Neni 4

Të drejtë për t'u zgjedhur dhe për t'u zgjedhur këshilltar, përkatësisht deputet gjëzon qytetari i Republikës së Malit të Zi i cili ka mbushur moshën 18 vjeç, i cili ka zotësi për t'u vepruar dhe i cili ka vendbanim në territorin e Republikës, përkatësisht në territorin e njësisë përkatëse të zgjedhjeve, të paktën 12 muaj para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: votuesi).

Neni 5

Askush, mbi çfarëdo baze, nuk mund ta thërrasë në përgjegjësi ëgjedhësin përsë ka votuar apo nuk ka votuar ose përsë ka votuar për listën e caktuar, as që të kërkojë nga ai që të deklarohet përsë nuk ka votuar, për kë ka votuar dhe shkakun përsë ka votuar.

Neni 6

Mbrojtjen e së drejtës së votimit e sigurojnë organet për mbajtjen e zgjedhjeve, gjykata kompetente dhe Gjykata Kushtetuese e Republikës së Malit të Zi.

Neni 7

Këshilltarët zgjedhen në komunë si njësi unike e zgjedhjeve. Deputetët zgjedhen në Republikën e Malit të Zi (në tekstin e mëtejmë: Republika), si njësi unike e zgjedhjeve.

Këshilltarët dhe deputetët zgjedhen me mandat katërvjeçar.

Neni 8

Këshilltarët, përkatesisht deputetët zgjedhen në njësinë e zgjedhjeve në bazë të listës së zgjedhësve të kandidatëve të cilën e paraqesin: partia politike, koalicioni i partive politike dhe grupi i qytetarëve (në tekstin e mëtejmë: lista e zgjedhësve).

Neni 9

Në kuvendin e komunës, të kryeqendrës dhe të kryeqytetit (në tekstin e mëtejmë: kuvendi i komunës) zgjedhen 30 këshilltarë dhe nga një këshilltar për çdo 5000 votues.

Numrin e këshilltarëve, në vështrim të paragrafit 1 të këtij nenit, e përcakton kuvendi i komunës me vendim të veçantë, jo më vonë se deri ditën e shpalljes së zgjedhjeve.

Numrin e deputetëve e përcakton me vendim të veçantë Kuvendi i Republikës së Malit të Zi (në tekstin e mëtejmë: Kuvendi i Republikës), jo më vonë se deri ditën e shpalljes së zgjedhjeve.

Neni 10

Mjetet për mbajtjen e zgjedhjeve për këshilltarë sigurohen në buxhetin e komunës, kurse për zgjedhjen e deputetëve – në buxhetin e Republikës.

Për veprimet, parashtresat, aktet dhe shkresat e tjera në lidhje me mbajtjen e zgjedhjeve dhe me përcaktimin e pushimit të mandalit të këshilltarëve dhe të deputetëve nuk paguhet taksë.

Neni 11

Në komunat në të cilat shumicën ose pjesën dërrmuese të votuesve e përbëjnë pjesëtarët e grupeve nationale ose etnike, ekstrakti nga lista e zgjedhësve, lista përmbledhëse e zgjedhësve dhe fletëvotimet shtypen edhe në gjuhën e tyre.

II - PROCEDURA DHE ORGANET PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE

1. SHPALLJA E ZGJEDHJEVE

Neni 12

Me vendimin e Kryetarit të Republikës për zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve përcaktohet dita e mbajtjes së zgjedhjeve dhe saktësohen afatet e veçanta për zbatimin e procedurave të zgjedhjeve të parashikuara me këtë ligj.

Vendimi për shpalljen e zgjedhjeve botohet në „Gazeten zyrtare të Republikës së Malit të Zi“ dhe në mjetet e informimit publik, themeluese e të cilave është Republika.

Neni 13

Zgjedhjet për këshilltarë dhe deputetë mbahen jo më vonë se 15 ditë para skadimit të periudhës për të cilën kanë qenë të zgjedhur këshilltarët, përkatësisht deputetët të cilëve u vazhdon mandati.

Nga dita e shpaljes së zgjedhjeve për këshilltarë dhe deputetë deri në ditën e caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve nuk mund të kalojnë më pak se 60 e as më shumë se 100 ditë.

Neni 14

Në rast të shpërndarjes së Kuvendit të Republikës apo të marrjes së vendimit për shkurtimin e mandalit të Kuvendit të Republikës, Kryetari i Republikës shpall zgjedhjet për deputetë të ditën kur me dekret përcakton shpërndarjen e Kuvendit, përkatësisht ditën e hyrjes në fuqi të vendimit për shkurtimin e mandatit (zgjedhjet e parakohshme).

Dispozita nga paragrafi 1 i këtij nenit zbatohet në mënyrë analoge edhe për shpaljen e zgjedhjeve për këshilltarë në rast të pushimit, përkatësisht të shkurtimit të mandatit të kuvendit të komunës.

Dispozita nga Neni 12, paragrafi 2, i këtij ligji zbatohet edhe në rastet nga paragrafët 1 dhe 2 të këtij nenit.

2. ORGANET PËR MBAJTJEN E ZGJEDHJEVE

1) Dispozita të përbashkëta

Neni 15

Organe për mbajtjen e zgjedhjeve janë komisionet e zgjedhjeve dhe këshillat e zgjedhjeve. Anëtarëve të organeve për mbajtjen e zgjedhjeve u emërohen zëvendësit.

Neni 16

Komisionet e zgjedhjeve përbëhen nga anëtarët e emëruar, kurse këshillat e zgjedhjeve nga anëtarët e emëruar dhe nga anëtarët në përbërje të zgjeruar.

Anëtarë të përbërjes së zgjeruar të këshillit të zgjedhjeve janë përfaqësuesit e autorizuar të paraqitesve të listave të shpallura të zgjedhësve.

Paraqitësi i listës së shpallur të zgjedhësve ka të drejtë të caktojë përfaqësuesin e autorizuar si vëzhgues të punës së komisionit të zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: vëzhguesi).

Secili paraqitës i listës së shpallur të zgjedhësve ka të drejtë të caktojë përfaqësuesin e autorizuar si anëtar të përbërjes së zgjeruar të këshillit të zgjedhësve dhe si vëzhgues.

Dy ose më shumë paraqitës të listave të shpallura të zgjedhësve mund të caktojnë përfaqësuesin e përbashkët si anëtar të përbërjes së zgjeruar të këshillit të zgjedhjeve dhe si vëzhgues.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve përcakton rregullat e hollësishme për mënyrën e ndjekjes së punës të komisioneve të zgjedhjeve nga vëzhguesit.

Neni 17

Anëtarë të organit për zbatimin e zgjedhjeve, zëvendës të e tyre dhe vëzhgue, mund të janë vetëm personat që kanë të drejtë vote dhe nuk mund të janë kandidatë për këshilltarë, përkatësisht për deputetë.

Anëtarëve të emëruar dhe zëvendësve të tyre u pushon detyra në organin për mbajtjen e zgjedhjeve posa të kenë pranuar kandidaturën

pér këshilltarë ose deputetë, kurse si anëtar në përbërje të zgjeruar të këshillit të zgjedhjeve, përkatësisht si vëzhgues nuk mund të caktohet personi që është kandidat në listën e zgjedhësve.

Neni 18

Komisionet e zgjedhjeve vendosin me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.

Puna e këshillave të zgjedhjeve është e plotfuqishme nëse është e pranishme shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve, kurse vendosin në mënyrë të plotëfuqishme me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm.

Neni 19

Organet pér mbajtjen e zgjedhjeve janë të pavarur dhe të mëvetësishëm në punën e vet dhe punojnë në bazë të ligjit dhe të dispozitave të miratuar në bazë të ligjit dhe janë përgjegjës pér të vepruar në mënyrë të ndërgjegjshme dhe të paanshme sipas ligjeve dhe dispozitave të tjera.

Me rastin e marrjes së detyrës, anëtari i organit pér mbajtjen e zgjedhjeve nënshkruan deklaratën me tekstin vijues: „Deklaroj se gjatë punës së organit pér mbajtjen e zgjedhjeve do t'i përmbahem ligjit dhe dispozitave të tjera të Republikës së Malit të Zi dhe detyrat e veta do t'i zbatoj në mënyrë të ndershme dhe të paanshme“.

Neni 20

Të gjitha organet dhe organizatat janë të detyruara që organeve pér mbajtjen e zgjedhjeve, me kërkesën e tyre, t'u japid ndihmë dhe t'u dërgojnë të dhënat e nevojshme pér punën e tyre.

Të punësuarit në organet dhe organizatat nga paragrafi 1 i këtij nenii janë të detyruar pér t'i ushtruar në mënyrë të ligjshme dhe të paanshme punët dhe detyrat që dalin nga procesi i zgjedhjeve, pavarësisht nga përkatësia e vet politike.

Neni 21

Puna e organit pér mbajtjen e zgjedhjeve është publike.

Neni 22

Anëtarët e organit pér mbajtjen e zgjedhjeve dhe personat që ndjekin punën e organit pér mbajtjen e zgjedhjeve janë të detyruar pér të vepruar në përputhje me ligj dhe me rregullat që i cakton Komisioni Republikan i Zgjedhjeve.

Në rastin kur personat që ndjekin punën e organit për mbajtjen e zgjedhjeve shkelin rregullat e punës në qendrën e votimit ose në ndonjë mënyrë tjetër pengojnë punën e organit për mbajtjen e zgjedhjeve, organi për mbajtjen e zgjedhjeve mund t'i largojë, kurse të dhënat në lidhje me këtë t'i shënojë në procesverbal.

Në pënën e organit për mbajtjen e zgjedhjeve nuk mund të marrë pjesë personi që është kandidat për këshilltar, përkatësisht deputet në listën e shpallur të zgjedhësve.

Neni 23

Përfaqësuesit e autorizuar të organizatave vendase dhe të institucioneve joqeveritare, qëllim i bashkimit të të cilave është mbrojtja e lirive dhe të drejtave të njeriut, përfaqësuesit e shteteve të huaja dhe të organizatave ndërkombëtare përkatëse si dhe të institucioneve ndërkombëtare joqeveritare ndjekin punën e organit për mbajtjen e zgjedhjeve, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

Përfaqësuesit e autorizuar të organizatave vendase dhe të institucioneve joqeveritare nga paragrafi 1 i këtij neni ndjekin punën e organit për mbajtjen e zgjedhjeve në bazë të autorizimit zyrtar të Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

Autorizimi zyrtar nga paragrafi 2 i këtij neni lëshohet në bazë të provës me shkrim për regjistrimin e kësaj organizate, përkatësisht të këtij institucioni në regjistër.

Neni 24

Përfaqësuesit e interesuar të shteteve të huaja dhe të organizatave dhe institucioneve joqeveritare ndërkombëtare ndjekin punën e organit për mbajtjen e zgjedhjeve në bazë të fletëparaqitjes që ia parashtrojnë Ministrisë së Punësve të Jashtme të Republikës së Malit të Zi, jo më vonë se pesë ditë para mbajtjes së zgjedhjeve.

Fletëparaqitia nga paragrafi 1 i këtij neni përbën: emërtimin e shtetit, përkatësisht të organizatës ose institucionit nga i cili vjen përfaqësuesi, numrin dhe përbërjen e përfaqësuesit dhe kohën e qëndrimit.

Ministria e Punëve të Jashtme, ditën e nesërme nga marrja e fletëparaqitjes, ia dërgon fletëparaqitjen Komisionit Republikan të Zgjedhjeve, i cili u lëshon autorizime zyrtare përfaqësuesve të vëzhguesve të huaj, në bazë të të cilave ata mund të ndjekin punën e organit për mbajtjen e zgjedhjeve.

Neni 25

Personave nga Neni 22 i këtij ligji, Komisioni Republikan i Zgjedhjeve u lëshon kartelën e identifikimit, në të cilën shënon emrin dhe

mbiemrin e personit, emrin e vendit nga i cili vjen, përkatësisht të organizatës apo të institucionit që i takon, të cilën personi është i detyruar pér ta mbajtur në një vend të dukshëm.

Pér autorizimet e lëshuara vëzhgesve të huaj dhe atyre të vendit Komisioni Republikan i Zgjedhjeve i njofton komisionet komunale të zgjedhjeve, të cilat i njoftojnë këshillat e zgjedhjeve në lidhje me këtë.

Neni 26

Këshilli i zgjedhjeve është i detyruar që vëzhguesit të huaj dhe atij të vendit t'i mundësojë kushtet pér të ndjekur në mënyrë të papenguar securinë e zgjedhjeve.

Këshilli i zgjedhjeve, në procesverbalin mbi punën e vet, konstaton praninë e vëzhguesve në qendrën e votimit.

Neni 27

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve, me propozimin e organit pér mbajtjen e zgjedhjeve mund t'ia marrë autorizimin dhe kartelën e identifikimit, po qe se personi të cilët i janë lëshuar nuk u përbahet dispozitave mbi punën e organit pér mbajtjen e zgjedhjeve.

2) Komisionet e zgjedhjeve

Neni 28

Komisione të zgjedhjeve janë komisionet komunale dhe Komisioni Republikan i Zgjedhjeve.

Neni 29

Komisioni komunal i zgjedhjeve përbëhet nga kryetari, sekretari dhe katër anëtarë, të cilët emërohen nga kuvendi i komunës, në bazë të propozimit të forumit (organit) të punës me kompetencë pér zgjedhje dhe emërimë.

Përbërja e komisionit në vështrim të paragrafit 1 të këtij nenit i përgjigjet përfaqësimit të partive politike në kuvendin e komunës.

Akti pér emërimin e komisionit komunal të zgjedhjeve bотohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Malit të Zi – dispozitat komunale”.

Neni 30

Kryetari, sekretari dhe anëtarët e komisionit komunal të zgjedhjeve dhe zëvendësit e tyre emërohen me mandat katervjeçar.

Për çdo dy vjet emërohen nga dy anëtarë të komisionit.

Kryetari, zéwendësi i tij, anëtarët e komisionit dhe zéwendësit e tyre, zakonish emërohen nga radha e juristëve të diplomuar.

Sekretari i komisionit komunal të zgjedhjeve emërohet nga radha e juristëve të diplomuar.

I njëjtë person nuk mund të zgjedhet më shumë se dy herë për kryetar.

Kryetarin dhe anëtarët e komisionit komunal të zgjedhjeve, në mungesë të tyre ose nëse janë të penguar për të ushtruar punët dhe detyrat në komision, i zéwendësojnë zéwendësit e tyre.

Neni 31

Me rastin e nxjerrjes së aktvendimit për shpalljen e listës së zgjedhësve, komisioni komunal i zgjedhjeve konstaton me konkluzion se paraqitësi i listës së zgjedhësve i plotëson kushtet për caktimin e vëzhguesve.

Konkluzionin nga paragrafi 1 i këtij nenit komisioni komunal i zgjedhjeve ia dërgon paraqitësit të listës së zgjedhësve njëkohësisht me aktvendimin për shpalljen e listës së zgjedhësve.

Paraqitësi i listës së zgjedhësve do të caktojë vëzhguesin e vet dhe do ta njoftojë në lidhje me këtë komisionin komunal të zgjedhjeve jo më vonë se tri ditë nga dita e dërgimit të konkluzionit nga paragrafi 2 i këtij nenit.

Komisioni komunal i zgjedhjeve është i detyruar që brenda 24 orëve nga çasti i marries së njoftimit nga paragrafi 3 i këtij nenit t'i mundësojë vëzhguesit kushtet për të qenë i pranishëm dhe për të ndjekue punë e tij, në përputhje me ligj dhe me rregullat e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

Neni 32

Komisioni komunal i zgjedhjeve:

- 1) kujdeset për ecurinë e ligjshme të zgjedhjeve;
- 2) organizon përgaditjet teknike për mbajtjen e zgjedhjeve;
- 3) cakton qendrat e votimit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve;
- 4) themelon këshillat e zgjedhjeve dhe emëron kryetarin dhe anëtarët e këshillave të zgjedhjeve për zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve;
- 5) cakton formën e fletëvotimit për zgjedhjen e këshilltarëve;
- 6) cakton mënyrën, vedin dhe kontrollin e shtypjes, shpërndarjen e fletëvotimeve, asgjesimin e matricës dhe çështjet e tjera në lidhje me sigurimin e fletëvotimeve;

- 7) përcakton numrin e fletëvotimeve pér zgjedhjen e këshilltarëve, që duhet të jetë identik me numrin e zgjedhësve të regjistruar në regjistrin e zgjedhësve, numrin e fletëvotimeve rezervë dhe numrin e fletëvotimeve pér zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve pér qendrat e veçanta të votimit;
- 8) vlerëson nëse listat e zgjedhësve pér zgjedhjen e këshilltarëve janë përpiluar dhe paraqitur në përputhje me këtë lig;
- 9) shpall listat e zgjedhësve pér zgjedhjen e këshilltarëve;
- 10) shpall publikisht numrin e zgjedhësve në komunë dhe sipas qendrave të votimit;
- 11) përcakton rezultatet e zgjedhjes së këshilltarëve, si dhe numrin e votave pér secilën listë të zgjedhësve dhe përcakton numrin e mandateve që i takon secilës listë të zgjedhësve pér zgjedhjen e këshilltarëve;
- 12) i lëshon vërtetim këshilltarit të zgjedhur;
- 13) përcakton rezultatet e përgjithshme të votimit pér zgjedhjen e deputetëve në territorin e vet në bazë të procesverbalit nga qendrat e votimit dhe në lidhje me këtë i dërgon raport Komisionit Republikan të Zgjedhjeve;
- 14) shpall publikisht rezultatet e zgjedhjeve të këshilltarëve;
- 15) i paraqet raport kuvendit të komunës pér rezultatet e zgjedhjes së këshilltarëve;
- 16) u dërgon të dhëna pér zgjedhjen e këshilltarëve organeve kompetente pér grumbullimin dhe përpunimin e të dhënavë statistikore;
- 17) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj, me rregullat dhe udhëzimet e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

Neni 33

Komisioni komunal i zgjedhjeve nxjerr rregulloren e vet të punës.

Kuvendi i komunës i siguron kushtet pér punën e komisionit komunal të zgjedhjeve.

Neni 34

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve përbëhet nga kryetari, sekretari dhe tetë anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi i Republikës, me propozimin e forumit të punës të Kuvendit pér zgjedhje dhe emërime.

Përbëra e Komisionit, në vështrim tëparagrafit 1 të këtij neni, i përgjigjet përfaqësimi të partive politike në Kuvend.

Vendimi për emërimin e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve botohet në „Gazetën zyrtare të Republikës së Malit të Zi”.

Neni 35

Kryetari, sekretari, anëtarët e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve dhe zëvendësit e tyre emërohen me mandat katërvjeçar.

Çdo dy vjet emërohen nga katër anëtarë të Komisionit.

Kryetari, zavendësi i tij, anëtarët dhe zëvendësit e tyre emërohen nga radha e juristëve të diplomuar, zakonisht nga radha e ekspertëve me përvojë.

Sekretari i komisionit emërohet nga radha e juristëve të diplomuar, e ekspertëve me përvojë dhe funksionin e ushtron në mënyrë profesionale.

I njëjti person nuk mund të zgjedhet kryetar më shumë se dy herë.

Kryetari dhe anëtarët e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve, në mungesë të tyre ose në rast se janë të penguar për të ushtruar punët dhe detyrat në Komision, zëvendësohen nga zëvendësit e tyre.

Neni 36

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve, me rastin e nxjerjes së aktvendimit për shpalljen e listës së zgjedhësve, konstaton me aktvendim se paraqitësi i listës së shpallur të zgjedhësve i plotëson kushtet për caktimin e vëzhguesit të vet në Komision.

Konkluzionin nga paragrafi 1 i këtij nenit, Komisioni Republikan i Zgjedhjeve ia dërgon paraqitësit të listës së zgjedhësve njëkohësisht me aktvendimin për shpalljen e listës së zgjedhësve.

Paraqitësi i listës së zgjedhësve do të caktojë vëzhguesin e vet dhe do ta njoftojë në lidhje me këtë Komisionin jo më vonë se tri ditë nga dita e dërgimit të konkluzionit nga paragrafi 2 i këtij nenit.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve është i detyruar që brenda 24 orëve nga çasti i marrjes së njoftimit nga paragrafi 3 i këtij nenit t'i mundësojë vëzhguesit kushtet për përfundim të qenë i pranishëm dhe përfundimisht përfundim i zgjedhjeve.

Neni 37

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve:

- 1) kujdeset për ecurinë e ligjshme të zgjedhjeve dhe përfundimisht përfundimisht përfundim i zgjedhjeve;
- 2) ndjek zbatimin e këtij ligji dhe jep mendime në lidhje me zbatimin e tij;

- 3) harmonizon punën e komisioneve komunale të zgjedhjeve dhe jep udhëzime në lidhje me zbatimin e këtij ligji dhe ushtron mbikëqyrjen e punës së tyre;
- 4) bashkëpunon me organet kompetente pér mbajtjen e regjistrave të zgjedhësve dhe ndërmerr veprime përkatëse me qëllim të saktësisë dhe të azhurnimit të regjistrave të zgjedhësve;
- 5) përcakton standardet unike pér materialin e zgjedhjeve dhe siguron teknikën e domosdoshme me qëllim të realizimit të masave të sigurisë;
- 6) cakton formularët pér zbatimin e veprimeve elektorale të parashikuara me kët ligj dhe përpilon kalendarin e aktiviteteve elektorale;
- 7) cakton mënyrën e shpaljes së listave të zgjedhësve;
- 8) cakton mënyrën e përdorimit dhe të tuajtjes së materialit të zgjedhjeve;
- 9) vlerëson nëse listat e zgjedhësve pér deputetë janë përpiluar dhe paraqitur në përputhje me këtë ligj;
- 10) nxjerr aktvendim pér shpaljen e listës së zgjedhësve pér deputetë;
- 11) shpall publikisht numrin e zgjedhësve në térësi, sipas komunave dhe sipas qendrave të votimit;
- 12) cakton formën e fletëvotimit pér zgjedhjen e deputetëve;
- 13) cakton mënyrën, vendin dhe kontrollin e shtypjes, shpërndarjen e fletëvotimeve, asgjësimin e matricës dhe çështjet e tjera në lidhje me sigurimin e fletëvotimeve (p.sh. numërtimi i fletëvotimeve, dërgimi i materialit të votimit në Mal të Zi etj.).
- 14) përcakton numrin e fletëvotimeve pér zgjedhjen e deputetëve, qe duhet të jetë identik me numrin e zgjedhësve të regjistruar në regjistrin e zgjedhësve dhe numrin e fletëvotimeve rezervë;
- 15) përcakton ngjyrën e fletëvotimeve pér zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve;
- 16) përcakton rezultatet e zgjedhjeve pér deputetë, si edhe numrin e votave pér secilën listë të zgjedhësve dhe përcakton numrin e mandateve që i takjonë secilës listë të zgjedhësve pér zgjedhjen e deputetëve;
- 17) shpall publikisht rezultatet e përgjithshme të zgjedhjeve të deputetëve pér secilën qendër votimi në Republikë;
- 18) i paraqet raport Kuvendit të Republikës pér zgjedhjet e kryera pér deputetë;
- 19) i lëshon vërtetim deputetit të zgjedhur;

- 20) u dërgon të dhëna mbi zgjedhjet për deputetë organeve me kompetencë për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave statistikore, dhe
- 21) kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me ligj.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve, në përputhje me ligj, mund të nxjerrë akte dhe të ndërmarrë masa për aftësimin profesional të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e zgjedhjeve.

Neni 38

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve një herë në vit i paraqet Kuvendit të Republikës raport për realizimin e legjislarionit elektoral në Republikë, për masat dhe aktivitetet e ndërmarra për përparimin e tij, bashkë me vlerësimet dhe propozimet për ndryshimin eventual të dispozitave që kanë të bëjnë me zgjedhjet.

Neni 39

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve do ta marrë përsipër kompetencën e komisionit komunal të zgjedhjeve, nëse konstaton se ai nuk i përbushë detyrimet e veta në përputhje me këtë ligj.

Neni 40

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve themelon shërbimin për kryerjen e punëve profesionale, administrative dhe punëve të tjera të përcaktuara me ligj.

Ndaj organizimit, sistematizimit të vendeve të punës, detyrimeve dhe përgjegjësive të nëpunësve të shërbimit nga paragrafi 1 i këtij nenit zbatohen në mënyrë analoge dispozitat e ligjit me të cilin rregullohen të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve shtetërorë.

Shërbimi nga paragrafi 1 i këtij nenit udhëhiqet nga sekretari i Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

Neni 41

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve nxjerr rregulloren e vet të punës.

Kuvendi i Republikës i siguron kushtet për punën e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

Neni 42

Krahas autorizimeve rregulluese konkrete që janë theksuar në këtë ligj, Komisioni Republikan i Zgjedhjeve është i autorizuar për të nxjerrë

dispozita me të cilat sigurohet zbatimi i këtij ligji, i Ligjit pér regjistrat e zgjedhësve dhe i Ligjit pér finacimin e partive politike.

3) Këshilli i zgjedhjeve

Neni 43

Këshilli i zgjedhjeve emërohet pér çdo zgjedhje të këshilltarëve, përkatësisht të deputetëve.

Këshilli i zgjelljeve përbëhet: nga kryetari dhe dy anëtarë në përbërje të përherershme dhe nga një përfaqësues i autorizuar i paraqitësit të listës së shpallur të zgjedhësve.

Kryetari dhe anëtarët e këshillit të zgjedhjeve në përbërje të përherershme i emërojnë zëvendësit e vet.

Përfaqësuesi i autorizuar i paraqitësit të listës së zgjedhësve mund të ketë zëvendësin.

Kryetari dhe anëtarët e këshillit të zgjedhjeve, si dhe përfaqësuesit e autorizuar të paraqitësve të listave të zgjedhësve, në mungesë të tyre apo në rast se janë të penguar në kryerjen e punëve dhe detyrate të këshillave të zgjedhjeve, zëvendësohen nga zëvendësit e tyre.

Këshilli i zgjedhjeve emërohet pér secilën qendër votimi, jo më vonë se 10 ditë para ditës së caktuar pér mbajtjen e zgjedhjeve.

Neni 44

Komisioni komunal i zgjedhjeve, me rastin e nxjerrjes së aktvendimit pér shpalljen e listës së zgjedhësve konstaton me konkluzion se paraqitësi i listës së zgjedhësve i plotëson kushtet pér caktimin e përfaqësuesit të autorizuar në përbërjen e zgjeruar të këshillit të zgjedhjeve.

Konkluzionin nga paragrafi 1 i këtij nenit komisioni komunal i zgjedhjeve ia dërgon paraqitësit të listës së shpallur të zgjedhësve brenda 24 orëve pas caktimit të qendrës së votimit.

Paraqitësi i listës së zgjedhësve do të caktojë përfaqësuesin e vet të autorizuar në përbërjen e zgjeruara të këshillit të zgjedhjeve dhe do ta njoftojë në lidhje me këtë komision komunal të zgjedhjeve jo më vonë se 48 orë nga çasti i marrjes së konkluzionit nga paragrafi 2 i këtij nenit, kurse komisioni është i detyruar që jo më vonë se 24 orë nga çasti i dërgimit të njoftimit t'i përcaktojë me konkluzion emër pér emër personat që hyjnë në përbërjen e zgjeruar të këshillit të zgjedhjeve.

Anëtari i këshillit të zgjedhjeve në përbërje të zgjeruar merr pjesë në punë dhe vendos në mënyrë të plot; fuqishme pesë ditë para ditës së caktuar pér mbajtjen e zgjedhjeve.

Neni 45

Këshilli i zgjedhjeve fillon drejtpërsëdrejti votimin në qendrën e votimit, siguron rregullsinë dhe fshehtësinë e votimit, përcakton rezultatet e votimit në qendrën e votimit dhe kryen edhe punë të tjera të caktuara me këtë ligj dhe me rregullat e Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

Këshilli i zgjedhjeve kujdeset për ruajtjen e rendit në qendrën e votimit gjat; kohës së votimit.

Këshilli i zgjedhjeve nga radha e anëtarëve të vet cakton dy persona të besuar për votim jashtë qendrës së votimit.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve cakton rregulla të hollësishme për punën e këshillit të zgjedhjeve dhe për ndarjen adekuate të punëve në këshillin e zgjedhjeve.

3. PROPZIMI DHE PËRCAKTIMI I LISTAVE TË ZGJEDHËSVE

1) Kandidatura dhe emërtimi i listës së zgjedhësve

Neni 46

Partitë politike të regjistrueshëm në Republikë, veç e veç ose bashkërisht, si dhe grupet e qytetarëve, i propozojnë kandidatët për listën e zgjedhësve, në bazë të numrit të caktuar të nënshkrimeve të zgjedhësve.

Listat e zgjedhësve propozohen sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 47

Një person mund të jetë kandidat për këshilltar vetëm në një listë të zgjedhësve.

Një person mund të jetë kandidat për deputet vetëm në një listë të zgjedhësve.

Në një listë të zgjedhësve mund të janë të paktën një e treta, kurse jo më shumë se numri i përgjithshëm i kandidatëve që zgjedhen.

Paraqitësi i listës së zgjedhësve cakton lirisht radhën e kandidatëve në listën e zgjedhësve.

Kandidati mund të heq dorë nga kandidatura deri ditën e nxjerrjes së aktvendimit për shpalljen e listës së zgjedhësve.

Neni 48

Paraqitësi i listës së zgjedhësve mund ta tërheqë listën jo më vonë se deri ditën e përcatimit të listës përmbledhëse të zgjedhësve.

Me térheqjen e listës së zgjedhësve i pushon funksioni përfaqësuesit të autorizuar të paraqitësit të listës në të gjitha organet për mbajtjen e zgjedhjeve, si dhe të gjitha dë drejtat që sipas dispozitave të këtij ligji i takojnë në cilësi të tillë.

Neni 49

Nëse pas nxjerrjes së aktvendimit për shpalljen e listës së zgjedhësve kandidatit me vendimin e formës së prerë të gjykatës i hiqet zotësia për të vepruar, humb shtetësinë malazeze, heq dorë nga kandidatura dhe në rast të vdekjes së kandidatit, paraqitësi i listës së zgjedhësve humb të drejtën për të propozuar kandidatin e ri.

Pozicionin në listën e zgjedhësve të kandidatit nga paragrafi 1 i këtij nenit e zë kandidati i cili vjen menjëherë pas tij në listën e zgjedhësve.

Neni 50

Emërtimi i listës së zgjedhësve caktohet sipas emërtimit të partisë politike e cila paraqet listën.

Nëse dy ose disa parti politike paraqesin listën e përbashkët të zgjedhësve, emërtimi dhe të drejtat dhe detyrimet e tjera të paraqitësve të listës së përbashkët të zgjedhësve caktohen me marrëveshjen e cila njëkohësisht me listën e përbashkët të zgjedhësve i dërgohet komisionit kompetent të zgjedhjeve.

Krahas emërtimit të listës së zgjedhësve të grupit të qytetarëve, paraqitësi cakton edhe shenjën e hollësishme të kësaj liste.

Në emërtimin e listës nga paragrafët 1 deri 3 të këtij nenit, paraqitësi i listës mund të shënojë edhe emrin e mbiemrin e kryesuesit të kësaj liste, në bazë të pëlgimit të tij me shkrim.

2) Përcaktimi dhe shpallja e listës së zgjedhësve

Neni 51

Lista e zgjedhësve për zgjedhjen e këshilltarëve quhet e përcaktuar nëse me nënshkrimet e veta përkrahet nga 1% – shi i numrit të përgjithshëm të zgjedhësve në njësinë e zgjedhjeve, llogaritur sipas të dhënavë për numrin e zgjedhësve nga zgjedhjet që i paraprijnë vendimit për shpalljen e zgjedhjeve, pavarasiqët nëse është fjalë për zgjedhjet për Kryetar të Republikës apo për zgjedhjet për kuvend.

Zgjedhësit të cilët nënshkruanë listat për zgjedhjen e këshilltarëve duhet të kenë vendbanim në territorin e komunës përkatëse.

Zgjedhësit të cilët nënshkruajnë listat për zgjedhjen e deputetëve duhet të kenë vendbanim në territorin e Republikës.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve cakton përbajtjen dhe formën e formularit për nënshkrimin e zgjedhësve nga paragrafi 1 i këtij neni.

Neni 52

Zgjedhësi me nënshkrimin e vet mund të mbështesë vetëm një listë të zgjedhësve për zgjedhjen e këshilltarëve dhe vetëm një listë të zgjedhësve për zgjedhjen e deputetëve.

Nënshkrimi i zgjedhësit i cili ka mbështetur më shumë se një listë të zgjedhësve është i pavlefshëm dhe prandaj konsiderohet se nuk ka mbështetur asnjë listë të zgjedhësve.

Komisioni kompetent i zgjedhjeve konstaton vlefshmërinë e nënshkrimit për mbështetjen e listave të zgjedhësve.

Neni 53

Grumbullimi i nënshkrimeve për propozimin e kandidatëve për listën e zgjedhësve inicohet dhe kryhet nga partitë politike, si dhe nga qytetarët, veç e veç ose kolektivisht.

Grumbullimi i nënshkrimeve nga paragrafi 1 i këtij neni nuk lejohet në vendet e punës, duke dhënë shpërblim financiar dhe shpërblime të tjera materiale dhe as duke përdorur çfarëdo lloji të presionit dhe shantazhit.

Personi i cili grumbullon nënshkrimet është i detyruar të nënshkruhet në anën e pasme të formularit për grumbullimin e nënshkrimeve dhe është përgjegjës për saktësinë e të dhënavë të zgjedhësve të nënshkruar.

Neni 54

Lista e zgjedhësve për zgjedhjen e këshilltarëve i dërgohet komisionit komunal të zgjedhjeve, kurse për zgjedhjen e deputetëve – Komisionit Republikan të Zgjedhjeve, jo më vonë se 30 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

Komisionit të zgjedhjeve së, bashku me listën e zgjedhësve i dërgohet edhe domunetacioni vijues:

- 1) deklarata e nënshkruar e secilit kandidat se e pranon kandidaturën;
- 2) vërtetimi për të drejtën e votimit për secilin kandidat nga lista e zgjedhësve;
- 3) vërtetimi për vendbanimin e secilit kandidat;

- 4) formulari me nënshkrimet e zgjedhësve të cilët mbështesin listën e zgjedhësve;
- 5) pëlqimi i nënshkruar i kryesuesit të listës që emri i tij të futet në emërtimin e listës.

Lista e zgjedhësve, bashkë me dokumentacionin nga paragrafi 2 i këtij neni, i dorëzohet drejtpërsëdrejti komisionit kompetent të zgjedhjeve.

Neni 55

Komisioni kompetent i zgjedhjeve, menjëherë pasi të ketë marrë listën e zgjedhësve, vlerëson nëse lista e zgjedhësve është paraqitur në afatin e duhur, nëse është përpiluar në përputhje me këtë ligj, si dhe plotësinë dhe vlefshmërinë e dokumentacionit dhe të të dhënavë në të.

Nëse komisioni kompetent i zgjedhjeve konstaton se lista e zgjedhësve nuk është paraqitur në afatin e duhur, do të nxjerrë aktvendim pér refuzimin e listës së zgjedhësve.

Nëse komisioni kompetent i zgjedhjeve konstaton se lista e zgjedhësve ose dokumentacioni përcjellës ka të meta, është i detyruar që jo më vonë se brenda 72 orëve pas marjes së listës së zgjedhësve të nxjerrë konkluzion me të cilin paraqitësit të listës së zgjedhësve do t'i urdhërojë që t'i menjanojë të metat, jo më vonë se brenda 48 orëve nga dërgimi i konkluzionit. Paraqitësi i listës së zgjedhësve paralajmërohet me konkluzion mbi të metat që duhet t'i menjanojë, përkatësishtë pér veprimet që duhet t'i kryejë pér t'i mënjanuar të metat.

Nëse komisioni kompetent i zgjedhjeve konstaton se nuk janë mënjanuar të metat në listën e zgjedhësve, brenda 24 orëve të ardhshme pas skadimit të afatit nga paragrafi 3 i këtij neni do të nxjerrë aktvendim me të cilin refuzohet shpaljja e kësaj liste të zgjedhësve.

Neni 56

Kur komisioni kompetent i zgjedhjeve konstaton se listat e paraqitura të zgjedhësve nuk kanë të meta apo se të metat janë menjanuar, shpall menjëherë listën e zgjedhësve dhe aktvendimin e shpaljës ia dërgon paraqitësit të listës së zgjedhësve.

3) Lista përbledhëse e zgjedhësve

Neni 57

Pas shpaljës së listave të zgjedhësve, komisioni kompetent i zgjedhjeve përcakton listën përbledhëse të zgjedhësve, e cila përmban të gjitha listat e zgjedhësve me emrat e të gjithë kandidatëve.

Radhën në listën përbledhëse të zgjedhësve e përcakton me short kryetari i komisionit të zgjedhjeve, në praninë e përfaqësuesve të autorizuar të paraqitësve të listave të shpallura të zgjedhësve.

Komisioni kompetent i zgjedhjeve shpall publikisht listën përbledhëse të zgjedhësve jo më vonë se 10 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjehjeve.

4. PREZENTIMI I PARAQITËSVE TË LISTAVE TË ZGJEDHËSVE DHE I KANDIDATËVE NGA LISTAT E ZGJEDHËSVE

Neni 58

Mjetet e informimit publik, themeluese e të cilave është Republika ose njësia e qeverisjes lokale, janë të detyruara të informojnë në mënyrë të paanshme, të barabartë dhe me kohë mbi të gjithë pjesëmarrësit e zgjedhjeve dhe mbi ecurinë e procesit të zgjedhjeve.

Për paraqitësin e listës së zgjedhësve propaganda elektorale nëpërmjet mjeteve të informimit publik nga paragrafi 1 i këtij nenit fillon ditën e shpalljes së saj.

Qytetarët kanë të drejtë që nëpërmjet mjeteve të informimit publik nga paragrafi 1 i këtij nenit të informohen për programet dhe aktivitetet elektorale të paraqitësve të listave të zgjedhësve, si dhe për kandidatët nga listat e zgjedhësve.

Me qëllim të realizimit të të drejtave të qytetarëve nga paragrafi 3 i këtij nenit, mjetet e informimit publik janë të detyruara për t'i zbatuar me konsekuençë parimet e barazisë së paraqitësve të listave të zgjedhësve dhe të kandidatëve nga këto lista.

Neni 59

Paraqitësit e listave të zgjedhësve kanë të drejtë që në mjetet e informimit publik nga Neni 58, paragrafit 1, i këtij ligji në kuadër të termineve, përkatësisht rubrikave të njëjtë ditore, t'i informojnë në mënyrë të barabartë qytetarët për programet dhe aktivitetet e veta.

Neni 60

Radiotelevizioni i Malit të Zi është i detyruar që, deri sa të përfundojë propaganda elektorale, në kuadër të programit politiko-informativ, dëgjueshmëria dhe dukshmëria e të cilit është siguruar në mbar territorin e Republikës, në të njëjtën kohëzgjatje dhe në të njëjtin termin, të

sigurojë prezentimin e paraqitësve të listave të zgjedhësve për deputetë, si dhe paraqitjen dhe prezentimin e programit elektoral.

Mjetit të informimit publik nga paragrafi 1 i këtij nenit nuk i lejohet që, në çfarëdo kushtesh, të mundësojë prezentimin dhe shpjegimin e programit elektoral të paraqitësve të listave të zgjedhësve në programin komercial, zbavitës apo në ndonjë program tjetër që nuk është politiko-informativ.

Neni 61

E përditshmja „Pobjeda“ është e detyruar që, derisa të ketë përfunduar propaganda elektorale, në faqet e veta të sigurojë të njëjtën hapsirë, përkatësishtë të njëjtat rubrika dhe kushte të barabarta për prezentimin e paraqitësve të listave të zgjedhësve për deputetë, si dhe prezentimin dhe shpjegimin e programit elektoral.

Neni 62

Radiotelevizioni i Malit të Zi është i detyruar që të paktën pesë herë gjatë kohës së propagandës elektorale, të shpallë falas dhe sipas mënyrës dhe kushteve me të cilat sigurohet pozita e barabartë e pjesëmarrësve, paralajmërimin e tubimit promovues të paraqitësve të listave të zgjedhësve për zgjedhjen e deputetëve.

E përditshmja „Pobjeda“ është e detyruar që gjatë kohës së propagandës elektorale të shpallë falas dhe sipas kushteve të parashikuara në paragrin 1 të këtij nenit paralajmërimet e të gjitha tubimeve promovuese të paraqitësve të listave të zgjedhësve për zgjedhjen e deputetëve.

Neni 63

Mjetet e informimit publik të cilat i publikojnë me pages; shpalljet e paraqitësve të listave të zgjedhësve me të cilat propagandohen zgjedhjet, programet e zgjedhjeve dhe kandidatët, janë të detyruara që në këtë shpallje të vënë shenjën „shpallja e paguar e zgjedhjeve“.

Për prezentimin e paraqitësve të listave të zgjedhësve nuk mund të shfrytëzohet pasuria (paratë, mjetet teknike, paisja etj.) e organeve shtetërore, e ndërmarrjeve publike, e institucioneve dhe fondeve publike dhe e Dhomës Ekonomike e Malit të Zi.

Neni 64

Kuvendi i Republikës merr vendimin për rregullat e përfaqësimit të partive politike gjatë kohës së propagandës elektorale, jo më vonë se 30

ditë para skadimit të afatit të fundit kur duhet të shpallen zgjedhjet, përkatësisht në të njëjtën kohë kur shpërndahet Kuvendi, përkatësisht kur ai të ketë marrë vendim për shkurtimin e mandatit.

Neni 65

Redaktorët dhe udhëheqësit e emisioneve politiko-informative dhe speciale të Radiotelevizionit të Malit të Zi janë të detyruar që gjatë kohës së propagandës elektorale t'i prezentojnë në mënyrë të pavarur dhe objektive të gjithë kandidatët, kurse udhëheqësit e emisioneve duhet të kenë qëndrim të paanshëm ndaj të gjitha programeve të përfaqësuara politike, sociale dhe etnico-kulturore.

Redaktorët nga paragrafi 1 i këtij nenit, në marrëveshje me paraqitësit e listave të zgjedhësve, përcaktojnë programin e prezentimit të tyre, në përputhje me ligj dhe me kriteret programore-redaktuese.

Radiotelevizioni i Malit të Zi është i detyruar të organizojë emisione me të cilat sigurohet ballafaqimi publik i programeve elektorale të paraqitësve të listave të zgjedhësve dhe të kandidatëve nga këto lista.

Neni 66

Mjetet e informimit publik nga Neni 58, paragrafi 1, i këtij ligji, përcaktojnë rregulla të hollësishme për prezentimin e paraqitësve të listave të zgjedhësve, të programeve elektorale dhe të kandidatëve nga listat e zgjedhësve, me pjesëmarjen e përfaqësuesve, të themeluesve dhe të paraqitësve të listave të zgjedhësve.

Neni 67

Paraqitësit e listave të zgjedhësve dhe kandidatët nga këto lista kanë të drejtë që gjatë kohës së propagandës elektorale, të organizojnë në kushte të barabarta konferanca dhe tubime të tjera publike në të cilat prezantohen dhe propagandohen programet elektorale, listat e zgjedhësve dhe kandidatët nga këto lista, në përputhje me dispozitat përrandin dhe qetësinë publike.

Neni 68

Mjetet e informimit publik nga Neni 58, paragrafi 1, i këtij ligji janë të detyruara që, në kuadër të mundësive materiale dhe teknike gjatë kohës së propagandës elektorale dhe në kushte të barabarta të informojnë për aktivitetet e paraqitësve të listave të zgjedhësve nga të gjitha konferencat dhe tubimet e tjera publike në të cilat prezantohen programet dhe kandidatët e paraqitësve të listave për zgjedhjen e deputetëve.

Paraqitësit e listave të zgjedhësve dhe mjetet e informimit publik nga paragrafi 1 i këtij neni përcaktojnë me marrëveshje mënyrën dhe kushtet e raportimit nga tubimi publik, si dhe afatet brenda të cilave paraqitësit e listave të zgjedhësve e njoftojnë mjetin e informimit publik për mbajtjen e tubimit publik.

Neni 69

Paraqitësit e listave të zgjedhësve dhe kandidatët nga lista e zgjedhësve kanë të drejtë që gjatë kohës së propagandës elektorale të pergatisin pllakata elektorale, shpallje, fotografji, afishe etj. dhe t'i ekspozojnë e t'i afishojnë publikisht pa leje të veçantë në vende publike, të cilat i caktos organi komunal kompetent.

Neni 70

Propaganda elektorale e cila organizohet me anë të aparateve zanore të shpalljes kryhet në kohën dhe sipas mënyrës me të cilën sigurohet që të mos rezikohet e drejta e qytetarëve për qetësi personale në pëpushje me dispozitat përendin dhe qetësinë publike.

Neni 71

Gjatë kohës së propagandës elektorale, mjetet e informimit publik janë të detyruara për t'i publikuar konstatimet e organeve kompetente me të cilat dëshmohet se mjeti i caktuar i informimit publik i ka shkelur parimet e barazisë dhe të objektivitetit të informimit të qytetarëve për programet dhe kandidatët e partive politike dhe të paraqitësve të tjera të listave të zgjedhësve, në emisionin e parë të ardhshëm qëndror-informativ, përkatesisht në numrin e parë të ardhshëm të publikimit.

Neni 72

Brenda shtatë ditëve para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve ndalohet që në mjetet e informimit publik të shpallen rezultatet e anketave publike, të hulumtimeve dhe të analizave në lidhje me disponimin e elektoratit përkitazi me vlerësimin e rezultateve të zgjedhjeve.

Në ditën e zgjedhjeve dhe deri në mbylljen e qendrave të votimit ndalohet publikimi i rezultateve preliminare ose vlerësimi i rezultateve të zgjedhjeve.

Neni 73

Propaganda elektorale nëpërmjet mjeteve të informimit publik dhe tubimeve promovuese pushon 48 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

5. MBAJTJA E ZGJEDHJEVE

1) Qendra e votimit

Neni 74

Votimi për zgjedhjen e këshilltarit, përkatësisht të deputetit kryhet në qendrën e votimit.

Qendra e votimit caktohet në bazë të propozimit të organit kompetent për mbajtjen e regjistrat të zgjedhësve, jo më vonë se 15 ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Qendra e votimit duhet të ketë sipërfaqe të mjaftueshme që të gjithë anëtarët e këshillit të votimit të mund t'i mbikëqyrin dhe t'i kontrollojnë në mënyrë të papenguar dhe në çdo moment kutit e votimit dhe materialin e zgjedhjeve.

Komisioni komunal i zgjedhjeve jo më vonë se 10 ditë para mbajtjes së zgjedhjeve, shpall se cilat qendra të votimit janë caktuar dhe cilët zgjedhës do të votojnë në qendrën e caktuar të votimit.

Neni 75

Qendra e votimit caktohet për votimin e jo më shumë se deri 1000 zgjedhës.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve përcakton rregulla të hollësishme për caktimin dhe rregullimin e qendrave të votimit dhe për mënyrën e veprimit në qendrën e votimit.

Neni 76

Organi i qeverisjes lokale me kompetencë për mbajtjen e regjistrat të zgjedhësve secilin zgjedhës e njofton për ditën dhe kohën e mbajtjes së zgjedhjeve, për numrin dhe adresën e qendrës së votimit ku votohet dhe për numrin me të cilin ai është regjistruar në ekstraktin nga regjistri i zgjedhësve, jo më vonë se pesë ditë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 77

Askujt nuk i lejohet të vijë në qendrën e votimit me armë apo me sende të rezikshme.

Në qendrën e votimit zgjedhësit nuk mund t'i përdorin telefonat celularë.

Në qendrën e votimit dhe në largësinë deri 50 metra nga qendra e votimit ndalohet afishimi i simboleve të partive politike dhe i materialit tjetër propagandistik.

Në rast të afishimit të simboleve të partive politike dhe të materialit tjetër propagandistik në largësinë deri 50 metra, anëtarët e këshillit të zgjedhjeve janë të autorizuar pér t'i menjanuar ato.

Neni 78

Pér secilën qendër votimi do të sigurohet lokal i veçantë në të cilin mund të sigurohet fshehtësia e votimit.

Në lokalin nga paragrafi 1 i këtij neni në të njëjtën kohë mund të jenë të pranishëm vetëm aq zgjedhës sa është numri i kabinave të votimit.

Ndalohet qëndrimi në qendrën e votimit pér të gjithë personat që nuk kanë të drejta dhe detyrime në lidhje me mbajtjen dhe ndjekjen e zgjedhjeve, të përcaktuara me këtë ligj.

Pér shkak të shkeljes së rregullave që përbahen në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni mund t'i paraqitet kundërshtim komisionit komunal të zgjedhjeve.

Neni 79

Komisioni komunal i zgjedhjeve është i detyruar që pér secilën qendër votimi të përgadisë me kohë materialin e votimit, e sidomos: numrin e nevojshëm të fletëvotimeve, listat përbledhëse të zgjedhësve, ekstraktin nga regjistri i zgjedhësve, zarfat e posaçme dhe zyrtare të votimit, si dhe formularin e procesverbalit mbi punën e këshillit të zgjedhjeve.

Kryetari dhe dy anëtarë të kishillit të zgjedhjeve marrin në dorëzim materialin nga paragrafi 1 i këtij neni në lokalet e komisionit komunal të zgjedhjeve, jo më vonë se 24 orë para ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Organë kompetent i komunës kujdeset pér rregullimin e qendrave të votimit dhe pér secilën qendër votimi përgatit nûmrin e nevojshëm të kutive të votimit, bashkë me mjetet pér vulosje dhe me mjetet e shkrimit.

Në ditën e zgjedhjeve, para se të ketë filluar votimi, këshilli i zgjedhjeve përcakton nëse materiali i përgaditur i zgjedhjeve pér këtë qendër votimi është i plotë dhe në gjendje të rregullt, nëse qendra e votimit është e rregulluar sipas mënyrës me të cilën sigurohet fshehtësia e votimit dhe nëse mund të fillojë votimi, dhe të gjithë këto shënohen në procesverbalin e punës të këshillit të zgjedhjeve.

Neni 80

Gjatë kohës së votimit në qendrën e votimit duhet të jetë afishuar në një vend të dukshëm lista përbledhëse e zgjedhësve.

Neni 81

Nëse prishet rendi në qendrën e votimit, këshilli i zgjedhjeve mund të ndërprefj votimin derisa të rivendoset rendi. Shkaqet dhe kohëzgjatja e ndërprerjes së votimit shënohen në procesverbalin e punës të këshillit të zgjedhjeve.

Pjesëtarët e policisë që janë në detyrë mund të hyjnë në qendrën e votimit vetëm me lejen e kryetarit të qendrës së votimit dhe vetëm atëherë kur në qendrën e votimit të janë prishur rendi dhe qetësia.

Nëse votimi është ndërpererë për një kohë më të gjatë se një orë, ai do të vazhdohet për të njëjtën kohë sa ka zgjatur ndërprerja.

Neni 82

Qendrat e votimit hapen në orën 7,00 dhe mbyllen në orën 20,00.

2) Votimi

Neni 83

Zgjedhësi voton në qendrën e votimit në të cilën është i regjistruar në ekstraktin nga regjistri i zgjedhësve.

Përashtimisht, zgjedhësi mund të votojë edhe jashtë qendrës së votimit në të cilën është regjistruar në ekstraktin nga regjistri i zgjedhësve, me anë të postës, sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligji.

Mënyra e votimit jashtë qendrës së votimit sipas paragrafit 2 të këtij nenit, si dhe numri i zgjedhësve të cilët kanë votuar në këtë mënyrë shënohen në procesverbalin e punës të këshillit të zgjedhjeve.

Neni 84

Secili zgjedhës voton personalisht dhe gjatë kohës së mbajtjes së zgjedhjeve mund të votojë vetëm një herë.

Votimi është i fshehtë.

Votimi bëhet në fletëvotim të vërtetuar.

Marrjen e vletëvotimit zgjedhësi e vërteton me nënshkrimin e vet në librin e veçantë të zgjedhësve, përbajtjen e të cilit e përcakton Komisioni Republikan i Zgjedhjeve.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve përcakton udhëzime të hollësishme përmes masave të cilat sigurohet fshehtësia e votimit.

Neni 85

Fletëvotimi përban:

- 1) shenjën se zgjedhjet bëhen pér këshilltarë, përkatësish pér deputetë;
- 2) emërtimin e listave të zgjedhësve sipas radhës së përcaktuar në listën përbledhëse të zgjedhësve;
- 3) numrin rendor para emërtimit të listës së zgjedhësve;
- 4) shënimin se votohet vetëm pér një listë të zgjedhësve, duke rrethuar numrin rendor para emërtimit të kësaj liste, përkatësish duke rrethuar emërtimin e listës apo emrin e mbiemrin e kryesuesit të listës;
- 5) në anën e pasme, në këndin e sipërm të djathtë, emërtimin e komunës, emërtimin e qendrës së votimit, shenjën e numrit të qendrës së votimit dhe vulën e këshillit të zgjedhjeve që përmban emërtimin dhe numrin e qendrës së votimit.

Neni 86

Këshilli i zgjedhjeve kontrollon kutinë e votimit në prani të zgjedhësit që vjen i pari në qendër të votimit. Rezultati i kontrollit regjistrohet në fletën e kontrollit e cila nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e këshillit të zgjedhjeve dhe nga zgjedhesi që ka ardhur i pari në qendër të votimit.

Në kutinë e votimit futet fleta e kontrollit e pastaj kulia dylloset në prani të zgjedhësit të parë, gjë që shënohet në procesverbalin e punës të këshillit të zgjedhjeve.

Pas hapes së kutisë së votimit së pari kontrollohet nëse në të ndodhet fleta e kontrollit. Komisioni Republika i Zgjedhjeve përcakton formularin e fletës së kontrollit.

Neni 87

Zgjedhesi së pari i tregon këshillit të zgjedhjeve emrin dhe mbiemrin e vet, e pastaj provon identitetin e vet me letërnjoftim ose me ndonjë dokument tjeter që përmban fotografi dhe në të cilin figuron numri i amzës.

Zgjedhesi nuk mund të votojë pa paraqitur prova pér identitetin e vet.

Provë e identitetit është secili dokument që përmban fotografinë dhe numrin e amzës së zgjedhësit, përkatësish numrin e letërnjoftimit të zgjedhësit.

Kryetari apo anëtari i këshillit të zgjedhjeve, pasi të ketë konstatuar identitetin e zgjedhësit, rrethon numrin rendor me të cilin zgjedhesi është regjistruar në ekstraktin nga regjistri i zgjedhësve, ia shpjegon mënyrën e votimit, vë vulën e këshillit të zgjedhjeve në fletëvotim dhe ia dorëzon fltëvotimin zgjedhësit.

Neni 88

Anëtari i këshillit të zgjedhjeve nuk guxon në asnjë mënyrë të ndikojë në vendimin e zgjedhësit.

Anëtari i këshillit të zgjedhjeve është i detyruar që zgjedhësit, me kërkesën e tij, t'ia shpjegojë përsëri mënyrën e votimit.

Anëtarët e këshillit të zgjedhjeve janë të detyruar sidomos të kujdesen që askush të mos e pengojë zgjedhësin me rastin e plotësimit të fletëvotimit dhe që të sigurohet fshehtësia e plotë e votimit.

Neni 89

Zgjedhësi mund të votojë vetëm për një listë të zgjedhësve nga fletëvotimi.

Votimi bëhet duke rrethuar numrin rendor para emërtimit të listës së zgjedhësve për të cilën votohet, përkatësisht duke rrethuar emërtimin e listës ose emrin e mbiemrin e kryesuesit të listës.

Zgjedhësi e palos vetë fletëvotimin e plotësuar në mënyrë që të mos shihet se për kë votuar dhe e futë në kutinë përkatëse të votimit, e pastaj largohet nga qendra e votimit.

Neni 90

Këshilli i zgjedhjeve nuk mund të bëjë kurrfarë ndryshimesh në ekstraktin e regjistrat të zgjedhësve.

Zgjedhësin i cili vjen për të votuar, e nuk është regjistruar në ekstraktin e regjistrat të zgjedhësve, këshilli i izgjedhjeve do ta evidencojë posaçërisht, bashkë me të dhënat përmes identitetit e tij dhe këtë evidencë do t'ia dorëzojë komisionit komunal të zgjedhjeve.

Zgjedhësit, të dhënat e identitetit të të cilil nuk përputhen me të dhënat në ekstraktin e regjistrat të zgjedhësve do t'i hiqet e drejta për të votuar, kurse në procesverbalin e punës të këshillit të zgjedhjeve shënohen shkaqet për të cilat i është hequr kjo e drejtë.

Neni 91

Zgjedhësi i cili nuk ka mëndësi për të votuar personalisht në qendrën e votimit (personi i verbër, invalid ose analfabet) ka të drejtë të marrë me vete personin i cili në vend të tij do të plotësojë fletëvotimin, përkatësisht do të votojë sipas dëshirës së zgjedhësit.

Mënyra e votimit të zgjedhësit nga paragrafi 1 i këtij nenit shënohet në procesverbal.

Neni 92

Zgjedhësi i cili nuk ka mundësi pér të votuar në qendrën e votimit (personi i paftë ose i sëmurë) e i cili dëshiron të votojë, do ta njoftojë në lidhje me këtë këshillin e zgjedhjeve, me anë të deklaratës së nënshkruar personalisht, përkatësisht me deklaratën e anëtarit të familjes, nëse ky person është analafabet, të paktën deri në ora 12 të ditës së votimit. Këshilli i zgjedhjeve nëpërmjet të besuarve të vet pér votim do t'i mundësojë personit të këtillë që të votojë me anë të postës, sipas mënyrës me të cilën sigurohet karakteri i drejtpërdrejtë dhe i fshehtë i votimit.

Pasi të jetë njoftuar pér pamundësinë e zgjedhësit pér të votuar në qendrën e votimit, këshilli i zgjedhjeve, nëpërmjet të besuarit pér votim me anë të postës do t'ia dërgojë zgjedhësit në një zarf zyrtar fletëvotimin e vërtetuar, listën përbledhëse të zgjedhësve dhe zarin e veçantë pér fletëvotimin e plotësuar.

Pasi zgjedhësi të ketë votuar, e mbyll fletëvotimin në zarin e veçantë të cilin i besuari e vulos dhe e dyllos në prani të tij. Zari i mbyllur në të cilin ndodhet fletëvotimi pastaj futet në zarin zyrtar të cilin i besuari poashtu e dyllos dhe e vulos në prani të zgjedhësit.

Të besuarit ia dorëzojnë këshillit të zgjedhjeve zyrtar të cilin këshilli i zgjedhjeve e hap, e rrëthon numrin rendor me të cilin zgjedhësi është regjistruar në ekstraktin e regjistrat të zgjedhësve, kurse zarin e mbyllur bashkë me fletëvotimin i fut në kutinë e votimit.

Mënyra e votimit të zgjedhësit nga paragrafi 1 i këtij nenit shënohet në procesverbal.

Neni 93

Zgjedhësit që ndodhen në shërbimin e afatit ushtarak ose në stërvitje ushtarake, përkatësisht të cilët kryejnë detyrimin në njësitet ose institucionet e Ushtrisë Jugosllave, votojnë në qendrat e posaçme të votimit të cilat i cakton Komisioni Republikan i Zgjedhjeve, në marrëveshje me organet e Ushtrisë Jugosllave.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve përcakton ekstraktet nga regjistri i zgjedhësve, përbërjen e këshillit të zgjedhjeve dhe mënyrën e votimit të personave nga paragrafi 1 i këtij nenit.

Neni 94

Zgjedhësit që ndodhen në paraburgim ose janë duke vuajtur dënimin me burgim votojnë në qendrën e posaçme të zgjedhjeve, të cilën e cakton Komisioni Republikan i Zgjedhjeve, në marrëveshje me organin e administratës me kompetencë pér ekzekutimin e sanksioneve penale.

3) Përcaktimi i rezultateve të votimit

Neni 95

Pasi të ketë përfunduar votimi, këshilli i zgjedhjeve fillon përcaktimin e rezultateve të votimit në qendrën e votimit.

Këshilli i zgjedhjeve përcakton numrin e fletëvotimeve të papërdorura dhe i fut në mbështjellës të veçantë që vuloset.

Në bazë të ekstraktit nga regjistri i zgjedhësve këshilli i zgjedhjeve përcakton numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar.

Kur të hapet kutia e votimit dhe pasi të jetë verifikuar lista e kontrollit, këshilli i zgjedhjeve përcakton numrin e fletëvotimeve të pavlefshme, pastaj numrin e fletëvotimeve të vlefshme, si dhe numrin e votave për se cilën listë të zgjedhësve, të cilat i shënon në procesverbal.

Fletëvotim i pavlefshëm është fletëvotimi i paplotësuar, fletëvotimi që është plotësuar ashtu që nuk mund të konstatohet se për cilën listë të zgjedhësve është votuar dhe fletëvotimi në të cilin janë rrethuar më shumë se një listë e zgjedhësve.

Neni 96

Kur këshilli i zgjedhjeve të ketë përcaktuar rezultatet e votimit, në procesverbalin e punës të këshillit të zgjedhjeve shënohen: numri i fletëvotimeve të marra; numri i fletëvotimeve të papërdorura; numri i fletëvotimeve të gjetura në kutinë e votimit; numri i fletëvotimeve të pavlefshme; numri i fletëvotimeve të vlefshme; numri i votave të dhëna për se cilën listë të zgjedhësve; numri i zgjedhësve sipas ekstraktit nga regjistri i zgjedhësve dhe numri i përgjithshëm i zgjedhësve që kanë votuar.

Në procesverbalin e punës të këshillit të zgjedhjeve shënohen edhe vërejtjet dhe mendimet e anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve, si dhe të gjitha faktet e tjera të rëndësishme për procesin e votimit.

Procesverbal i punës së këshillit të zgjedhjeve nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e këshillit të zgjedhjeve.

Secili anëtar i këshillit të zgjedhjeve merr një kopje të procesverbalit të punës së këshillit të zgjedhjeve.

Neni 97

Pasi të ketë përcaktuar rezultatet e votimit, këshilli i zgjedhjeve do t'ia dorëzojë komisionit komunal të zgjedhjeve pa vonesë, por jo më vonë se 12 orë pas mbydhjes së qendrës së votimit: procesverbalin e punës, bashkë me ekstraktin nga regjistri i zgjedhësve, fletëvotimet e papërdorura dhe veçmas fletëvotimet e pavlefshme, veçmas fletëvotimet

e vlefshme, vulën e këshillit të zgjedhjeve, si dhe materialin tepricë të zgjedhjeve.

Kryetari i këshillit të zgjedhjeve, së bashku me dy përfaqësues të autorizuar të listave të zgjedhësve që kanë fituar numrin më të madh të votave në qendrën e votimit, ia dorëzon komisionit komunal të zgjedhjeve materialin e vulosur të zgjedhjeve nga paragrafi 1 i këtij nenit.

Neni 98

Pasi të ketë marrë materialin e zgjedhjeve nga qendrat e votimit, komisioni komunal i zgjedhjeve përcakton: numrin e përgjithshëm të zgjedhësve të shënuar në regjistrin e zgjedhësve; numrin e zgjedhësve që kanë votuar; numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të marra në qendrën e votimit; numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të papërdorura; numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të pavlefhshme; numrin e përgjithshëm të fletëvotimeve të vlefshme dhe numrin e votave të dhëna veç e veç pér secilën listë të zgjedhësve pér zgjedhjen e këshilltarëve.

Në bazë të rezultateve të votimit në të gjitha qendrat e votimit, komisioni komunal i zgjedhjeve përcakton rezultatet e përkohshme pér zgjedhjen e këshilltarëve, brenda 12 orëve pas marrjes së procesverbaleve të këshillave të zgjedhjeve.

Komisioni komunal i zgjedhjeve përcakton rezultatet e vitimit pér deputetë në qendrat e votimit në territorin e vet, jo më vonë se 12 orëve pas marrjes së procesverbaleve nga qendrat e votimit dhe Komisionit Republikan të Zgjedhjeve i dërgon raport në lidhje me këtë bashkë me procesverbalin mbi punën e vet.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve përcakton rezultatet e përkohshme të zgjedhjeve pér deputetë, brenda 12 orëve pas dërgimit të raporteve të komisioneve komunale të zgjedhjeve.

4) Mbrojtja e së drejtës së votimit

Neni 99

Organet kompetente pér mbajtjen e zgjedhjeve janë të detyruara që gjatë kohës së procesit të zgjedhjeve t'i informojnë zgjedhësit pér të drejtat e tyre të votimit dhe pér mënyrën e mbrojtjes së këtyre të drejtave.

Neni 100

Secili zgjedhës, kandidat dhe paraqitës i listës së zgjedhësve ka të drejtë t'i paraqesë kundërshtim komisionit kompetent të zgjedhjeve pér shkak të shkeljes së të drejtës së votimit gjatë kohës së zgjedhjeve.

Kundërshtimi nga paragrafi 1 i këtij neni paraqitet brenda 24 orëve nga çasti i marrjes së vendimit, përkatësishtë i kryerjes së veprimit.

Kundërshtimi nga paragrafi 1 i këtij neni i dorëzohet drejtëpersëdrejti komisionit kompetent të zgjedhjeve.

Neni 101

Kundërshtimi ndaj vendimit, veprimit ose lëshimit të këshillit të zgjedhjeve i paraqitet komisionit komunal të zgjedhjeve.

Kundërshtimi ndaj vendimit, veprimit ose lëshimit të komisionit komunal të zgjedhjeve i paraqitet Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

Neni 102

Komisioni kompetent i zgjedhjeve nxjerr aktvendim brenda 48 orëve nga çasti i marrjes së kundërshtimit dhe ia dërgon paraqitësit të kundërshtimit.

Komisioni kompetent i zgjedhjeve do të refuzojë kundërshtimin ndaj veprimeve dhe procedurave të këshillit të zgjedhjeve për të cilat nuk ka pasur vërejtje në procesverbalin e punës të këshillit të zgjedhjeve.

Nëse komisioni kompetent i zgjedhjeve në lidhje me kundërshtimin nuk nxjerr aktvendim brenda afateve të parashikuara me këtë ligj, do të konsiderohet se kundërshtimi është miratuar.

Neni 103

Ndaj aktvendimit të komisionit kompetent të zgjedhjeve me të cilin është vendosur në lidhje me kundërshtimin mund t'i paraqitet kundërshtimi Komisionit Republikan të Zgjedhjeve.

Ndaj aktvendimit të Komisionit Republikan të Zgjedhjeve me të cilin është vendosur në lidhje me kundërshtimin mund të ushtrohet ankesë para Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Malit të Zi, brenda 24 orëve nga çasti i dorëzimit të aktvendimit dhe i dorëzohet drejtëpersëdrejti Gjykatës Kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vends rrëth ankesës nga paragrafi 2 i këtij neni brenda 48 orëve nga çasti i marrjes së ankesës.

Neni 104

Në qoftë se këshilli i zgjedhjeve konstaton se:

- 1) fleta e kontrollit nuk ndodhet në kutinë e votimit;
- 2) numri i fletëvotimeve të vërtetuara në kutinë e votimit është më i madh se numri i zgjedhësve që janë nënshkruar;

do ta njoftojë në lidhje me këtë komisionin kompetent të zgjedhjeve, i cili do të vendosë që këshilli i zgjedhjeve të shpërndahet, të emërohet këshilli i ri dhe votimi në këtë qendër votimi të përsëritet.

Neni 105

Në qoftë se është paraqitur kundërshtimi:

- 1) se nuk kanë qenë siguruar kushtet pér fshehtësinë e votimit;
- 2) se zgjedhesi nuk ka votuar personalisht;
- 3) se nuk është konstatuar identiteti i zgjedhësit sipas mënyrës së përcaktuar me këtë ligj;
- 4) se anëtarë i këshillit të zgjedhjeve ka ndikuar në bindjen e zgjedhësit;

kurse shumica e anëtarëve të këshillit të zgjedhjeve nga këto shkaqe ka refuzuar pér ta nënshkruar procesverbalin e punës të këshillit të zgjedhjeve, komisioni kompetent i zgjedhjeve mund të vendosë që këshilli i zgjedhjeve të shpërndahet, të emërohet këshilli i ri dhe votimi në këtë qendër votimi të përsëritet.

Neni 106

Në rastin kur kundërshtimi paraqitet pér shkak të shkeljes së rregullave të votimit, me përjashtim të shkeljeve të rregullave sipas neneve 104 dhe 105, kurse komisioni kompetent i zgjedhjeve konstaton se është i bazuar, do t'i japë vërejtje publike këshillit të zgjedhjeve, anëtarit të këshillit të zgjedhjeve, paraqitësit të listës së zgjedhësve ose zgjedhësit.

Neni 107

Për veprimet në lidhje me dërgimin e aktvendimeve, konkluzioneve si dhe akteve, shkresave, dokumenteve dhe parashtresave të tjera të njashme, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe, zbatohen në mënyrë analoge rregullat e dërgimit të tyre në procedurën administrative.

Neni 108

Përfaqësuesit e paraqitësve të listave të zgjedhësve dhe kandidatët pér këshilltarë dhe deputetë kanë të drejtë të mbikëqyrin materialin e zgjedhjeve, e sidomos ekstraktet nga registrat e zgjedhësve, procesverbalet e këshillit të zgjedhjeve, procesverbalet e komisioneve të zgjedhjeve dhe fletëvotimet. Mbikëqyrja ushtrohet në lokalet zyrtare të komisionit të zgjedhjeve, si dhe tek organet në të cilat ndodhet materiali i zgjedhjeve.

Me kërkesën e paraqitësit të listës së zgjedhësve, organet te të cilat ndodhet materiali i zgjedhjeve janë të detyruara për të lejuar fotokopijimin e tyre me shpenzimin e paraqitësit të kërkesës.

Mbiqëqyrja e materialit të zgjedhjeve mund të ushtrohet brenda pesë ditëve pas ditës së mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 109

Materiali i zgjedhjeve ruhet të paktën katër vjet.

Përjashtimi nga dispozita e paragrafit 1 të këtij neni, fletëvotimet ruhen 60 ditë, përkatsishtë derisa të përfundojë procedura rreth shkeljes së të drejtave gjatë kohës së zgjedhjeve.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve cakton mënyrën e ruajtjes dhe të shfrytëzimit të materialit të zgjedhjeve.

6. NDARJA E MANDATEVE DHE SHPALLJA E REZULTATEVE TË ZGJEDHJEVE

1) Ndarja e mandateve

Neni 110

Komisioni komunal i zgjedhjeve për zgjedhjen e këshilltarëve, kurse Komisioni Republikan i Zgjedhjeve për zgedhjen e deputetëve përcaktojnë numrin e përgjithshëm të votave që ka fituar secila listë e zgjedhësve veç e veç dhe përcaktojnë numrin e mandateve që i takojnë asaj liste.

Secilës listë të zgjedhësve i takon numri i mandateve që është në përpjesëtim me numrin e votave të marra.

Neni 111

Në ndarjen e mandateve marrin pjesë vetëm listat e zgjedhësve që kanë fituar të paktën 2% të numrit të përgjithshëm të votave të zgjedhësve që kanë votuar në njësinë e zgjedhjeve.

Neni 112

Numri i mandateve që do të fitojë lista e veçantë e zgjedhësve përcaktohet duke pjesëtuar numrin e përgjithshëm të votave që ka marrë secila listë e veçantë në njësinë e zgjedhjeve me numrat 1,2 dhe ... përfundimisht me numrin që përputhet me numrin e këshilltarëve, përkatësisht të deputetëve që zgjedhen në njësinë e zgjedhjeve. Herësat

e fituar në këtë mënyrë klasifikohen sipas madhësisë, duke marrë në konsiderim numrin e tillë tē herësave sa ç'është numri i këshilltarëve, përkatësisht i deputetëve që zgjedhen.

Secila listë e zgjedhësve fiton aq mandate sa herësah i takojnë asaj.

Nëse dy ose më shumë lista tē zgjedhësve fitojnë të njëjtë herës në bazë të tē cilëve do tē fitonin një mandat, me short caktohet se cilës listë do t'i ndahet ky mandat.

Neni 113

Në kuadër tē numrit tē përgjithshëm tē mandateve që ka firuar lista e zgjedhësve, mandatet u ndahan kandidatëve nga lista e zgjedhësve sipas radhës në listë.

Neni 114

Në rastin kur sipas rezultateve tē votimit tē përcaktuara sipas mënyrës nga Neni 112 i këtij ligji, lista e veçantë e zgjedhësve fiton numër më tē madh mandatesh se numri i kandidatëve që ndodhen në këtë listë, këto mandate u takojnë listave tē zgjedhësve që kanë herësin më tē madh vijues.

Neni 115

Komisioni komunal i zgjedhjeve përcakton rezultatet përfundimtare tē zgjedhjeve pér këshilltarë, brenda 12 orëve pas skadimit tē afatit pér paraqitjen e kundërshtimeve, përkatësisht tē ankesave, gjegjishtë pasi që vendimet e marra rreth kundërshtimeve ose ankesave tē kenë marrë formën e prerë ose tē ekzekutueshme.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve përcakton rezultatet përfundimtare tē zgjedhjeve pér deputetë brenda 12 orëve pas skadimit tē afatit pér paraqitjen e kundërshtimeve, përkatësisht tē ankesave, gjegjishtë pasi që vendimet e marra rreth kundërshtimeve ose ankesave tē kenë marrë formën e prerë ose tē ekzekutueshme.

2) Shpallja e rezultateve tē zgjedhjeve

Neni 116

Në kuadër tē rezultateve përfundimtare, komisioni komunal i zgjedhjeve pér zgjedhjen e këshilltarëve, kurse Komisioni Reublikan i Zgjedhjeve pér zgjedhjen e deputetëve, shpallin publikisht tē dhënat pér:

- 1) numrin ë zgjedhësve tē regjistruar në regjistrin e zgjedhësve;
- 2) numrin e zgjedhësve që kanë votuar në qendër tē votimit;

- 3) numrin e zgjedhësve që kanë votuar jashtë qendrës së votimit;
- 4) numrin e përgjithshëm të zgjedhësve që kanë votuar;
- 5) numrin e fletëvotimeve të marra;
- 6) numrin e fletëvotimeve të papërdorura;
- 7) numrin e fletëvotimeve të përdorura;
- 8) numrin e fletëvotimeve të pavlefshme;
- 9) numrin e fletëvotimeve të vlefshme;
- 10) numrin e votave që ka fituar secila listë e zgjedhësve veç e veç;
- 11) numrin e mandateve që ka fituar secila listë e zgjedhësve veç e veç.

Rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve për deputetë shpallen në „Gazetën zyrtare të Republikës së Malit të Zi“, kurse për këshilltarë në „Gazetën zyrtare të Republikës së Malit të Zi – Dispozitat komunale“, jo më vonë se brenda 15 ditëve nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

Neni 117

Ditën e verifikimit të mandatit komisioni komunal i zgjedhjeve këshilltarit të zgjedhur, kurse Komisioni Republikan i Zgjedhjeve deputetit të zgjedhur i lëshon vërtetimin se është zgjedhur këshilltar, përkatësisht deputet.

3) Zgjedhjet e përsëritura

Neni 118

Zgjedhjet e përsëritura mbahen po qe se komisioni kompetent i zgjedhjeve anulon zgjedhjet në qendrën e veçantë të votimit, për shkaqe të përcaktuara me këtë ligj.

Në rastin nga paragrafi 1 i këtij nenit votimi përsëritet vetëm në atë qendër votimi. Zgjedhjet e përsëritura mbahen sipas mënyrës dhe procedurës përmes mbajtjenës e zgjedhjeve që janë përcaktuar me këtë ligj.

Neni 119

Zgjedhjet e përsëritura shpallen nga komisioni kompetent i zgjedhjeve.

Zgjedhjet e përsëritura mbahen jo më vonë se brenda shtatë ditëve nga data e anulimit të zgjedhjeve.

Përmes mbajtjenës e zgjedhjeve të përsëritura listat e zgjedhësve nuk mund të ndryshohen.

Në rastin e përsëritjes së zgjedhjeve, rezultatet përfundimtare të zgjedhjeve përcaktohen pasi të ketë përfunduar përsëritja e votimit.

III - SHPENZIMET E MBAJTJES SË ZGJEDHJEVE DHE TË PROPAGANDËS ELEKTORALE

Neni 120

Mjetet pér punën e organeve pér mbajtjen e zgjedhjeve, materiali i zgjedhjeve dhe shpenzimet e tjera pér mbajtjen e zgjedhjeve sigurohen nga kuvendi i komunës pér zgjedhjen e këshilltarëve, kurse nga Kuvendi i Republikës pér zgjedhjen e deputetëve. Komisioni kompetent i zgjedhjeve paraqet kërkesën pér ndarjen e mjeteve bashkë me specifikimin e shpenzimeve totale.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve përcakton kriteret e shpërndarjes së mjeteve dhe ato ua shpërndan komisioneve komunale të zgjedhjeve pér kryerjen e punëve përkatëse gjatë procesit të zgjedhjeve pér deputetë.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve cakton mënyrën e shfrytëzimit dhe ushtron kontrollin e përdorimit të mjeteve nga paragrafi 2 i këtij neni.

Mjetet që paguhen si shpërblim pér punën e personave në organet pér mbajtjen e zgjedhjeve tirohen nga pagimi i tatimeve dhe kontributiveve.

Neni 121

Organet shtetërore dhe organet e qeverisjes lokale i vëjnë në dispozicion lokalet e veta, instalimet, mjetet dhe paisjen e vet pér ushtrimin e propagandës elektorale dhe të gjithë paraqitësve të listave të zgjedhësve u sigurojnë kushte të barabarta pér shfrytëzimin e tyre.

Organet nga paragrafi 1 i këtij neni, në marrëveshje me paraqitësit e listave të zgjedhësve, brenda 10 ditëve nga data e shpalljes së zgjedhjeve përcaktojnë kushtet dhe mënyrën e shfrytëzimit të mjeteve nga paragrafi 1 i këtij neni.

IV - KOHËZGJATJA DHE PUSHIMI I MANDATIT

1. Kohëzgjatja e mandatit

Neni 122

Mandati i këshilltarit, përkatësisht i deputetit zgjat katër vjet.

Mandati i këshilltarit, përkatësisht i deputetit fillon ditën e verifikimit të mandatit.

Verifikimi i mandatit bëhet brenda 15 ditëve nga dita e mbajtjes së zgjedhjeve.

Ditën e verifikimit të mandatit të këshilltarit, përkatësisht të deputetit të legjislaturës së re pushon mandati i këshilltarëve, përkatësisht i deputetëve të legjislaturës paraprake.

2. Pushimi i mandatit

Neni 123

Këshilltarit, përkatësisht deputetit i pushon mandati para skadimit të periudhës për të cilën është emëruar:

- 1) pas shpërndarjes së kuvendit, përkatësisht pasi të jetë marrë vendimi për shkurtimin e mandatit të kuvendit;
- 2) duke dhënë dorëheqje;
- 3) nëse humb vendbanimin në territorin e Republikës;
- 4) nëse me vendimin e formës së prerë të gjykatës është dënuar me burgim pa kusht në kohëzgjatje prej të paktën gjashtë muajve, ose është dënuar me burgim për vepër penale që e bën të padenjë për ushtrimin e këtij funksioni;
- 5) nëse me vendimin e formës së prerë të gjykatës i është hequr zotësia për të vepruar;
- 6) nëse shfaqet ndonjëri nga rastet e mospërputhjes së funksionit të këshilltarit, përkatësisht të deputetit me ndonjë funksion tjetër të përcaktuar me Kushtetutë dhe me ligj;
- 7) pasi t'i ketë pushuar shtetësia malazeze;
- 8) në rast të vdekjes së tij;
- 9) pasi të ketë dalë vullnetarisht nga anëtarësia e partisë politike, nga lista e zgjedhësve e së cilës është zgjedhur;
- 10) pas përjashtimit nga partia politike, me përjashtim të rastit kur Gjykata Kushtetuese, rrëth kundërshtimit të këshilltarit, përkatësisht të deputetit që parashtronet brenda tri ditëve nga data e përjashtimit, konstaton se përjashtimi është bërë vetëm për arsy që këshilltarit, përkatësisht deputetit t'i pshoje mandati;
- 11) nëse ndalohet puna e partisë politike, nga lista e zgjedhësve e së cilës është zgjedhur.

Këshilltarit, përkatësisht deputetit i pushon mandati ditën kur të jetë shfaqur rasti nga paragrafi 1 i këtij neni.

Pushimi i mandatit, përpos rasteve nga pikë 1 e këtij neni, konstatohet nga kuvendi kompetent, në seancën e parë të ardhshme pas marrjes së njofitimit për shkaqet e pushimit të mandatit të këshilltarit, përkatësisht të deputetit.

Këshilltar, përkatësisht deputeti të cilit i ka pushuar mandati në bazë të paragrafit 1, pikë 6) të këtij neni mbetet në listën e zgjedhësve dhe në përputhje me këtë ligj mund të fitojë përsëri mandatin e këshilltarit, përkatësisht të deputetit.

3. Plotësimi i vendeve të zbrazëta të këshilltarëve dhe të deputetëve

Neni 124

Në qoftë se këshilltarit, përkatësisht deputetit i pushon mandati nga shkaqet e përcaktuara në Nenin 123, me përjashtim të pikave 1) dhe 11) të këtij ligji, mandatin e fiton këshilltar, përkatësisht deputeti i ri, sipas mënyrës së përcaktuar me këtë nen.

Kur këshilltarit, përkatësisht deputetit i pushon mandati në rastet sipas paragrafit 1 të këtij neni, mandati i takon paraqitësit të listës së zgjedhësve, këshilltarit, përkatësisht deputetit të të cilit i ka pushuar mandati dhe ky mandat i jepet kandidatit i cili sipas radhës vjen menjëherë pas tij në listën e zgjedhësve.

Në qoftë se në listën e zgjedhësve nga e cila ka qenë zgjedhur këshilltar, përkatësisht deputeti të cilit i ka pushuar mandati nuk ka kandidat, këshilltar, përkatësisht deputet i zgjedhur do të konsiderohet kandidati nga lista e zgjedhësve e cila sipas madhësisë ka herësin më të madh vijues.

Mandati i këshilltarit, përkatësisht i deputetit të ri zgjat deri me skadimin e mandatit të këshilltarit, përkatësisht të deputetit të cilit i ka pushuar mandati.

V - DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 125

Me gjobë ose me dënim me burgim deri në një vit do të dënohet për veprer penale: ai i cili pasi të kenë përfunduar zgjedhjet e thirret në përgjegjësi zgjedhësin për shkak të votimit ose kérkon nga ai të tregojë se si ka votuar ose përsë nuk ka votuar.

Nëse vepra nga paragrafi 1 i këtij neni kryhet nga anëtari i komisionit të zgjedhjeve, i këshillit të zgjedhjeve apo nga personi tjetër gjatë

kryerjes së detyrimeve në lidhje me zgjedhjet, do të dënohet me burgim prej tre muajve deri në tri vjet.

Neni 126

Me gjobë prej pesëfishit deri në njëzetfishin e shumës së pagës minimale në Republikë ose me burgim deri 60 ditë do të dënohet për kundërvajtje:

- 1) ai që ushtron propagandë në kundërshtim me dispozitën e Nenit 73 të këtij ligji;
- 2) ai që pranon kandidaturat në kundërshtim me dispozitën e Nenit 47 të këtij ligji;
- 3) ai i cili me rastin e propozimit të kandidatit vë nënshkrimin e vet në kundërshtim me dispozitën e Nenit 52 të këtij ligji;
- 4) ai i cili për prezentimin e listave të zgjedhësve përdor pasurinë në kundërshtim me Nenin 63, paragrafi 2, të këtij ligji;
- 5) ai që pengon punën e këshillit të zgjedhjeve, mbajtjen e zgjedhjeve, përkatësisht votimin ose punën e komisionit të zgjedhjeve;
- 6) ai i cili pasi të ketë votuar, pas paralajmërimit të kryetarit të këshillit të zgjedhjeve nuk largohet nga qendra e votimit, në kundërshtim me dispozitën e Nenit 78 të këtij ligji;
- 7) ai i cili në kundërdhëtim me dipozitën e Nenit 77 të këtij ligji vjen në qendër të votimit me armë apo me material tjetër të rrezikshëm;
- 8) ai që grumbullon nënshkrime të zgjedhësve në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji;
- 9) ai i cili si anëtar i organit për mbajtjen e zgjedhjeve vepron në mënyrë të njëanshme dhe në kundërshtim me deklaratën nga Neni 19, paragrafi 2.

Krahas dënimit për kundërvajtjen nga paragrafi 1, pika 7), i këtij nenii ekzekutuesit do ti shqiptohet edhe masa mbrojtëse e marrjes së armës, përkatësisht e materialit të rrezikshëm.

Neni 127

Me gjobë në shumën prej pesëfishit deri në treqindfishin e pagës minimale në Republikë do të dënohet për kundërvajtje mjeti i informimit publik dhe institucioni tjetër i informimit:

- 1) nëse nuk vepron sipas dispozitave të neneve 60, 61, 62, 65, 67 dhe 71 të këtij ligji;
- 2) nëse vepron në kundërshtim me dispozitën e Nenit 72 të këtij ligji.

Me gjobë në shumën prej pesëfishit deri në njëzetfishin e pagës minimale në Republikë do të dënohet pér kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personi përgjegjës në mjetin e informimit publik dhe në institucionin tjeter të informimit.

VI - DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 128

Zgjedhjet e para në përputhje me këtë ligj do të mbahen pas skadimit, përkatësisht pas pushimit të mandateve të kuvendeve të komunave, përkatësisht të Kuvendit të Republikës në përbërje të tashme.

Neni 129

Komisionet komunale të zgjedhjeve dhe Komisioni Republikan i Zgjedhjeve në përbërje të tashme mbeten në detyrë deri sa të skadojë periudha pér të cilën janë emëruar.

Neni 130

Kuvendet e komunave do t'i harmonizojnë dispozitat e veta të zgjedhjeve me dispozitat e këtij ligji brenda 60 ditëve nga hyrja e këtij ligji në fuqi.

Neni 131

Me rastin e emërimit të parë të komisioneve të zgjedhjeve në përputhje me këtë ligj, kuvendi komunal do të caktojë se cilëve anëtarë të komisionit të zgjedhjeve u zjat mandati dy vjet, sipas Nenit 30, paragrafi 2 dhe sipas Nenit 35 , paragrafi 2, të këtij ligji.

Neni 132

Ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi shfuqizohet Ligji pér zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve („Gazeta zyrtare e RMZ“, nr.4/98 dhe 17/98), me përashtim të dispozitës së Nenit 124, me të cilën është rregulluar procedura e plotësimit të vendeve të zbrazëta të deputetëve, e cila mbetet në fuqi derisa t'u pushojet mandati kuvendeve në përbërje të tashme.

Neni 133

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të Republikës së Malit të Zi“.

MODEL I LIGJIT PËR REGJISTRAT E ZGJEDHËSVE

Neni 1

Regjistri i zgjedhësve është dokument publik në të cilin mbahet evidenca e qytetarëve të cilët, në përputhje me ligjin, kanë të drejtë votimi dhe shërben vetëm për zgjedhje.

Neni 2

Regjistri i zgjedhësve mbahet sipas detyrës zyrtare.

Regjistri i zgjedhësve është unik, i përhershëm dhe azhurnohet rregullisht.

Regjistri i zgjedhësve përpilohet dhe mbahet në bazë të të dhënave nga evidencat zyrtare të organeve shtetërore dhe të dhënave të marra drejtpërsëdrejti nga qytetarët, në përputhje me këtë ligj.

Neni 3

Regjistri i zgjedhësve mbahet për rajonin e njësisë së qeverisjes lokale, në bazë të vendbanimit dhe sipas qendrave të votimit.

Qytetari mund të regjistrohet në regjistrin e zgjedhësve vetëm një herë, vetëm në një njësi të qeverisjes lokale dhe vetëm në një qëndër votimi.

Regjistri i zgjedhësve përpilohet dhe mbahet nga organi i qeverisjes lokale, kurse për saktësinë dhe azhurnitetin e regjistrat të zgjedhësve është përgjegjës titullari i funksionit ekzekutiv në njësinë e qeverisjes lokale.

Neni 4

Regjistrat e zgjedhësve, të përpiluar dhe të përpunuar në njësitë e qeverisjes lokalet sipas qendrave të votimit, bashkohen në Regjistrin qendror të zgjedhësve.

Regjistri qendror i zgjedhësve mbahet nga Sekretariati Republika për Zhvillim dhe ai përgjigjet për saktësinë dhe azhurnitetin e tij.

Mbajtja e Regjistrat qendror të zgjedhësve nga paragrafi 2 i këtij nenit përfshin: analizën e regjistrave të zgjedhësve të organeve të qeverisjes lokale; gjetjen e gabimeve dhe të metave eventuale në këta regjistra; informimin e organeve kompetente dhe ndërmarrjen e veprimeve teknike përkatëse dhe veprimeve të tjera me qëllim të saktësisë dhe të

azhurnimit tē regjistrave tē zgjedħesve dhe bashkimin e Regjistrat qendror tē zgjedħesve mbi bazën e regjistrave individuale tē zgjedħesve tē organeve tē qeverisjes lokale.

Neni 5

Sekretariati Republikan pér Zhvillim, nē vēshtrim tē Nenit 4, paragrafet 2 dhe 3 tē kētij ligji, ka tē drejtē dhe pér detyrē qē organeve tē qeverisjes lokale t'u sugjerojé pér gabimet dhe lëshimet e konstatuara dhe tē kērkojé nga ato qē tē ndērmarrin veprime dhe procedura me qéllim tē saktēsisé dhe azhurnimit tē regjistrat tē zgjedħesve.

Organet e qeverisjes lokale me kompetencē pér mbajtjen e regjistrat tē zgjedħesve janē tē detyruara pér tē vepruar menjéheré sipas udhēzimeve, qëndrimeve dhe kérkesave nga paragrafi 1 i kētj nenī.

Organet nga paragrafi 2 i kētj nenī janē tē detyruara pér tē vepruar edhe sipas dispozitave dhe udhēzimeve tē Komisionit Republikan tē Zgħejha pērkitazi me saktēsinē dhe azhurnitetin e regjistrat tē zgjedħesve.

Neni 6

Regjistrat e zgjedħesve nē njēsítē e qeverisjes lokale pērpunohen dhe mbahen me anē tē pērpunimit kompjutorik tē tē dhēnave, sipas programit unik tē cilin e cakton Sekretariati Republikan pér Zhvillim.

Organet pér mbajtjen e regjistrat tē zgjedħesve, nga organet qē mbajnē evidenca zyrtare pér qytetarét i marrin zyrtarisht tē dhēnat e nevojshme pér regjistrin e zgjedħesve, i evidencojnē dhe i verifikojnē tē gjitha tē dhēnat e marra, i analizojnē regjistrat e zgjedħesve, i konstatojnē gabimet dhe tē metat nē regjistrin e zgjedħesve, ndērmarrin masa dhe veprime pér mēnjanimin e tyre dhe masa e veprime pér saktēsinē dhe azhurnimin e regjistrat tē zgjedħesve.

Neni 7

Nē regjistrin e zgjedħesve regjistrohen qytetarét tē cilēt kanē tē drejtē votimi ose tē cilēt fitojnē tē drejtēn e votimit nē ditēn kur mbahen zgħejha.

Nē regjistrin e zgjedħesve regjistrohen edhe qytetarét qē banojnē nē botēn e jashtme, sipas vendbanimit tē tyre tē fundit para vajtjes nē botēn e jashtme.

Qytetarét tē cilēt ndodhen nē sherbimin e detyrimit ushtarak ose nē stërvitje ushtarake, si dhe qytetarét qē ndodhen nē paraburgim ose nē vuajtjen e dēnimit me burgim regjistrohen nē regjistrin e zgjedħesve sipas vendbanimit tē tyre tē fundit.

Në regjistrin e zgjedhësve nuk mund të regjistrohen qytetarët të cilët me vendimin e plotëfuqishëm të gjykatës janë të privuar nga zotësia për të vepruar; në qoftë se kanë qenë të regjistruar do të shlyhen nga regjistri i zgjedhësve, mirëpo posa me vendimin e plotëfuqishëm të gjykatës t'u jetë kthyer zotësia për të vepruar, do të regjistrohen në regjistrin e zgjedhësve.

Neni 8

Në regjistrin e zgjedhësve shënohen emri e mbiemri, vendbanimi me adresë dhe numri unik i amzës i qytetarit. Përjashtimisht, po qe se qytetarit nuk i është caktuar numri unik i amzës, në regjistrin e zgjedhësve shënohet numri i letërnjoftimit.

Neni 9

Organ i qeverisjes lokale me kompetencë për mbajtjen e regjistrat të zgjedhësve bën regjistrimin në regjistrin e zgjedhësve, shlyerjen nga regjistri i zgjedhësve dhe korrigimin në regjistrin e zgjedhësve, në bazë të evidencave dhe të dhënave nga librat e amzës, nga evidencat e tjera zyrtare dhe nga dokumentet publike, në bazë të verifikimit të drejtpërdrejtë dhe në bazë të dhënave dhe të dokumenteve publike të cilat qytetarët ia bashkëngjesin kërkesës për regjistrimin, shlyerjen ose korrigimin në regjistrin e zgjedhësve.

Organet që mbajnë evidencia zyrtare për qytetarët janë të detyruara që organeve kompetente për mbajtjen e regjistrat të zgjedhësve t'u dërgojnë të dhënat që janë me rëndësi për saktësinë dhe azhurnitetin e regjistrat të zgjedhësve, brenda shtatë ditëve nga dita që ka lindur ndryshimi, kurse organi kompetent për mbajtjen e regjistrat të zgjedhësve është i detyruar për t'i evidencuar menjëherë këto të dhëna dhe për ta azhurnuar regjistrin e zgjedhësve.

Neni 10

Organ i qeverisjes lokale me kompetencë për mbajtjen e regjistrat të zgjedhësve është i detyruar që herë pas here, por të paktën një herë në vit, të verifikojë gjendjen e të dhënave në regjistrin e zgjedhësve dhe brenda të njëjtë afat t'i informojë në mënyrë përkatëse qytetarët mbi të drejtën për të ushtruar mbikqyrjen e regjistrat të zgjedhësve dhe për të kerkuar regjistrimin, shlyerjen ose ndryshime të tjera në të, për të realizuar të drejtën e vet të votimit.

Brenda shtatë ditëve nga dita e shpalljes së zgjedhjeve, organi kompetent për mbajtjen e regjistrat të zgjedhësve shpall regjistrin e zgjedhësve dhe i informon qytetarët se mund të ushtrojnë mbikëqyrjen e

regjistrat tē zgjedħesve, tē kerkkojnē regjistrimin, shlyerjen, ndryshimin, plotësimin ose korrigjimin e regjistrat tē zgjedħesve.

Informimi nga paragrafet 1 dhe 2 tē kētij nenī bēhet me anē tē shpalljes publike nē mjetet e informimit publik, e sipas nevoje edhe nē ndonjē ményrē tjetr.

Neni 11

Komisioni Republikan i Zgħedhje rreggallon mē hollēsish ményrēn e mbajtjes, tē korrigjimit, tē dērgimit, tē mbylljes, tē kopjimit dha tē afishimit tē regjistrat tē zgjedħesve dha ċeşhtjet e tħera qé paraqesin rēndesi pér mbajtjen e plotè, tē pērpiktē dha azhurne tē regjistrat tē zgjedħesve.

Neni 12

Qytetari ka tē drejtē qé organit, tē qeverisjes lokale me kompetencē pér mbajtjen e regjistrat tē zgjedħesve t'i paraqes ġarr-ġewwa karki pér regjistrimin, shlyerjen dha korrigjimin e tē dhénav nē regjistrin e zgjedħesve pér vehte ose pér ndonjē qytetar tjetr pér tē cilin ēshté i sigurté ose ka ndonjē provē tē vlefshme pér regjistrimin e pasaktē nē regjistrin e zgjedħesve.

Kérkeses nga paragrafi 1 i kētij nenī qytetari ka pér detyrē t'ia bashkengjesprovē pér faktet dha rrreħanat pér tē cilat ka sygerime, e tē cilat ndikojnē nē saktēsinē e regjistrat tē zgjedħesve.

Organis pér mbajtjen e regjistrat tē zgjedħesve ēshté i detyruar pér ta shqyrtuar kérkesen dha pér t'i verifikuar zyrtarisht tē dhénav dha rrreħanat qé pērmbahen nē kérkes.

Rreħ kérkeses nga paragrafi 1 i kētij nenī, organi kopotent pér mbajtjen e regjistrat tē zgjedħesve do tē nxjerrē aktvendim brenda 5 ditvē, nē qoftē se kérkesa ēshté paraqit nē vēsħtrim tē Nenit 10, paragrafi 1, pērkatisi brenda 48 orēva, nē qoftē se kérkesa ēshté paraqit nē vēsħtrim tē Nenit 10, paragrafi 2 tē kētij ligji dha aktvendimin t'ia dērgoje menjēherē paraqit esit tē kérkes.

Neni 13

Kundēr aktvendimit nga Neni 12, paragrafi 4, i kētij ligji mund tē ushtrohet padi para Għjakat-Is-Supreme tē Republikas sē Malit tē Zi (nē tekst tibbi minn-nejja).

Padia nga paragrafi 1 i kētij nenī ushtrohet brenda 48 orēva nga ċasti i doręzimit tē aktvendimit nēpērmjet organit qé ka nxjerrē aktvendimin dha i cili ēshté i detyruar qé padinē dha shkresat e

nevojshme t`ia dërgojë Gjykatës brenda 24 orëve nga çasti i marrjes së padisë.

Gjykata vendos rreth padisë në kontestin administrativ brenda pesë ditëve, nëse aktvendimi është nxjerrë sipas kërkesës nga Neni 10, paragrafi 1, përkatësisht brenda 24 orëve, nëse aktvendimi është nxjerrë sipas kërkesës nga Neni 10, paragrafi 2, i këtij ligji.

Vendimi i Gjykatës është i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm.

Neni 14

Regjistri i zgjedhësve mbylljet jo më vonë se 20 ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve. Organi kompetent do të nxjerrë aktvendim për mbylljen e regjistrat të zgjedhësve, i cili përmban detyrimisht numrin e përgjithshëm të qytetarëve të regjistruar në regjistrin e zgjedhësve dhe datën e mbydhjes së regjistrat të zgjedhësve.

Aktvendimi për mbylljen e regjistrat të zgjedhësve i dërgohet komisionit komunal të zgjedhjeve jo më vonë se brenda 24 orëve nga çasti i nxjerrjes së aktvendimit.

Komisioni komunal i zgjedhjeve, brenda 24 orëve nga çasti i marrjes së aktvendimit, ia dërgon Komisionit Republikan të Zgjedhjeve të dhënët për numrin e përgjithshëm të zgjedhësve në njësinë e qeverisjes lokale.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve, brenda 24 orëve nga çasti i marrjes së të dhënave, shpall publikisht numrin e zgjedhësve në tërësi sipas njësive të qeverisjes lokale dhe sipas qendrave të votimit.

Neni 15

Pas mbylljes së regjistrat të zgjedhësve, regjistrimi, shlyerja, ndryshimet, plotësimet dhe korrigimet në të mund të bëhen vetëm në bazë të vendimit të Gjykatës, në kontestin administrativ, jo më vonë se pesë ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve shpall numrin total të zgjedhësve në tërësi, sipas njësive të qeverisjes lokale dhe qendrave të votimit, brenda 48 orëve pas skadimit të afatit nga paragrafi 1 i këtij nenit.

Neni 16

Organi kompetent për mbajtjen e regjistrat të zgjedhësve përpilon ekstraktin e vërtetuar nga regjistri i zgjedhësve për secilën qendër votimi. Ekstrakti i dërgohet komisionit komunal të zgjedhjeve brenda 24 orëve pas shpalljes së regjistrat të zgjedhësve nga Neni 15, paragrafi 2, i këtij ligji.

Ekstrakti nga regjistri i zgjedhësve, përveç të dhënave nga Neni 8, paragrafi 1, i këtij ligji përmban: emërtimin e organit që e ka përpiluar,

daten e pērpilimit dhe shenjēn e qendrēs sē votimit pér tē cilēn ēshtē pērpiluar ekstrakti.

Sekretariati Republikan pér Zvhillim ēshtē i detyruar qē paraqitēsit tē listes sē zgjedħesve, me kérkesen e tij, t'ia dërgojē regjistrin e zgjedħesve tē pērpunuar nē disketē kompjutorit apo nē ndonjē ménŷrē tjetér, brenda 48 orēve nga dita e paraqitjes sē kérkesés.

Neni 17

Pērfaqēsuesit e paraqitēsive tē listave tē zgjedħesve kanē tē drejtē mbikēqyrjeje tē regjistrat tē zgjedħesve dhe tē dokumentacionit zyrtar tē organit nē bazē tē cilit kryhet regjistrimi, shlyerja, ndryshimet, plotēsimet ose korrigjimet e regjistrat tē zgjedħesve.

Mbikēqyrja bēhet nē lokalet zyrtare tē organit tek i cili ndodhet dokumentacioni zyrtar.

Neni 18

Mbikēqyrja e inspektimit mbi punēn e organit tē qeverisjes lokale pērkitazi me zbatimin e normave me tē cilat rregullohet mbajtja e regjistrave tē zgjedħesve ushtrohet nga ministria kompetente pér česhjte administrative.

Kur ministria kompetente pér česhjte administrative konstaton se regjistri i zgjedħesve nuk mbahet sipas ménŷrēs sē parashikuar me ligj dhe me dispozitat e nxjerra nē bazē tē ligjit, do t'i urdhérojē organit kompetent pér t'i evituar parregullisitē e konstatuara.

Neni 19

Me dēnim deri njē vit burg do tē dēnohet pér vepér penale:

- 1) ai i cili, duke pasur pér qđellim pér ta penguar tjetrin qē tē votojē, nuk e regjistron nē regjistrin e zgjedħesve ose e shlyen nga regjistri i zgjedħesve;
- 2) ai qē jep tē dhéna tē rreme pér vendbanimin e vet dhe pér tē drejtēn e votimit ose tē dhéna tē rreme pér qytetarin tjetér qē janē nē lidhje me regjistrin e zgjedħesve.

Neni 20

Me gjobē tē paktēn sa pesēfishi i shumēs sē pagave minimale nē Republikē, do tē dēnohet pér kundervajtje:

- 1) personi përgjegjës të cilit i është besuar mbajtja e regjistrave të zgjedhësve, në qoftë se nuk siguron saktësinë dhe azhurnimin e tyre;
- 2) titullari i funksionit ekzekutiv në njësinë e qeverisjes lokale dhe personi përgjegjës i organit të qeverisjes lokale, në qoftë se nuk ushtron kontrollin e saktësisë dhe të mbajtjes azhurne të regjistrave të zgjedhësve;
- 3) personi përgjegjës në ministri, i ngarkuar me punë administrative, në qoftë se nuk ushtron mbikëqyrjen e inspektimit nga Neni 18 i këtij ligji;
- 4) personi përgjegjës i organit i cili është i detyruar pér t'i dërguar në kohë të dhënat nga Neni 9, paragrafi 2, i këtij ligji;
- 5) personi përgjegjës i organit me kompetencë pér mbajtjen e Regjistrat qendror të zgjedhësve, në qoftë se nuk i dërgon të dhënat brenda afatit të parashikuar me Nenin 16, paragrafi 3, të këtij ligji.

Neni 21

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve është i detyruar që brenda 60 ditëve nga data e hyrjes së këtij ligji në fuqi të nxjerrë dispozita nga Neni 11 i këtij ligji, me të cilat sigurohet zbatimi i këtij ligji.

Organet kompetente të qeverisjes lokale dhe Sekretariati Republikan pér Zhvillim janë të detyruar që regjistrat e zgjedhësve t'i përgatisin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të përpilojë Regjistrin qendror të zgjedhësve nga Neni 4 i këtij ligji jo më vonë se 60 ditë nga dita e nxjerrjes së dispozitave nga paragrafi 1 i këtij nenı.

Neni 22

Ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi shfuqizohet Ligji pér regjistrat e zgjedhësve („Gazeta zyrtare e Republikës së Malit të Zi”, nr.4/98).

Neni 23

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas shpalljes në „Gazetën zyrtare të Republikës së Malit të Zi”.

MODEL I LIGJIT PËR FINANCIMIN E ORGANIZATAVE POLITIKE

Neni 1

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e sigurimit të mjetave për punën e organizatave politike dhe të paraqitësve të listave të shpallura të zgjedhësve, mënyra e sigurimit të mjetave dhe mënyra e raportimit të organizatave politike dhe të paraqitësve të listave të shpalluara të zgjedhësve për veprimtarinë e tyre financiare.

Neni 2

Veprimtaria financiare e organizatave politike dhe e paraqitësve të listave të shpalluara të zgjedhësve i nënshtronhet kontrollit të shërbimit kompetent për kontrollin e veprimtarisë materiale-financiare të personave juridikë.

Neni 3

Organizata politike, përkastësisht paraqitësi i listës së shpallur të zgjedhësve mund të fitojë mjetë për punën e vet: nga kuotat e anëtarësisë, nga kontributet, nga të ardhurat nga pasuria e vet dhe nga veprimtaria sipërmarrëse, nga huat, kreditë, dhuratat, legatat, trashëgimitë, nga buxheti dhe nga burimet e tjera në përputhje me ligjin.

Organizata politike, përkastësisht paraqitësi i listës së shpallur të zgjedhësve mund të ushtrojë veprimtari ekonomike dhe veprimtari tjetër në përputhje me dispozitat me të cilat rregullohet ushtrimi i kësaj veprimtarie.

Neni 4

Mjetet të cilat i fitojnë organizata politike dhe paraqitësit e listave të shpallura të zgjedhësve evidencoohen në llogarinë e organizatës, në përputhje me dispozitat për veprimtarinë financiare, për çka organizata politike mban evidencë.

Neni 5

Republika, përkastësisht komuna në buxhetin e vet sigurojnë një pjesë të mjetave:

- 1) për punën e organizatës politike e cila ka deputetë, përkastësisht këshilltarë;

2) për mbulimin e shpenzimeve të propagandës elektorale të paraqitësit të listës së shpallur të zgjedhësve për zgjedhjen e deputetëve, përkatësisht të këshilltarëve.

Mjetet financiare nga paragrafi 1 i këtij neni nuk mund të janë më pak se 0,5% të të ardhurave të përgjithshme buxhetore për vitin për të cilin miratohet buxheti.

Neni 6

Mjetet nga Neni 5 i këtij ligji në shumën prej 30% u ndahen në shuma të barabarta organizatave politike që kanë deputetë, përkatësisht këshilltarë në kuvend dhe deputetit të grupit të qytetarëve, kurse teprica e mjeteve ndahet përpjesëtimisht me numrin e përgjithshëm të mandateve të deputetëve, përkatësisht të këshilltarëve.

Organi kompetent për çështje të financave mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni ia derdhë çdo muaj organizatës politike, deri më datën 5 të muajit për muajin paraprak.

Neni 7

Mjetet për mbulimin e shpenzimeve të propagandës elektorale për zgjedhjen e deputetëve sigurohen në Buxhetin e Republikës në shumën 1% të mjeteve të përgjithshme buxhetore në vitin në të cilin janë shpallur zgjedhjet,

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni shpërndahen ashtu që:

- 1) një e treta e mjeteve u ndahet paraqitësve të listave të vërtetuara të zgjedhësve jo më vonë se brenda 10 ditëve nga dita e vërtetimit të listës së sgjedhësve;
- 2) dy të tretat e mjeteve u ndahen organizatave politike të cilat fitojnë mandate depëtetësh, përkatësisht deputetit të grupit të qytetarëve, përpjesëtimisht me numrin e mandateve të fituara në Kuvend, kundrejt numrit të përgjithshëm të mandateve.

Komisioni Republikan i Zgjedhjeve (në tekstin e mëtejmë: Komisioni) bën shpérndarjen e mjeteve sipas mënyrës nga paragrafi 2 i këtij neni.

Komisioni rregullon hollësisht mënyrën dhe afatet e shpérndarjes së mjeteve nga paragrafi 2 i këtij neni.

Neni 8

Mjetet për mbulimin e shpenzimeve të propagandës elektorale për zgjedhjen e këshilltarëve sigurohen në buxhetin e komunës, në shumën 1% të mjeteve të përgjithshme buxhetore në vitin në të cilin janë shpallur

zgjedhjet dhe ato shpérndahen sipas ménrys së përcaktuar në Nenit 7, paragrafi 2, të këtij ligji.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni i sigurohen komisionit komunal të zgjedhjeve, i cili bën shpérndarjen e këtyre mjeteve.

Neni 9

Shpenzimet e propagandës elektorale që kanë të bëjnë me: pllakatat, shpalljet, emisionet në radio dhe në televizion, spotet dhe publikimet reklamuese nuk mund të tejkalojnë shumën prej 250 pagash mesatare në Republikë pér muajin e fundit para fillimit të propagandës elektorale.

Ministria e Financave do të caktojë shumën e saktë të mjeteve nga paragrafi 1 i këtij neni dhe do ta njoftojë Komisionin pér këtë shumë jo më vonë se tri ditë pas shpalljes së zgjedhjeve.

Neni 10

Me qellim të mbulimit të shpenzimeve të propagandës elektorale, oraganizatat politike dhe paraqitësit e listave të shpallura të zgjedhësve mund të grumbullojnë kontribute.

Grumbullimi i kontributeve nga paragrafi 1 i këtij neni mund të bëhet në lokalet zyrtare të organzatës politike, përkatësisht të paraqitësit të listës së shpallur të zgjedhësve, në manifestimet dhe tubimet publike që i organizon organizata politike, përkatësisht paraqitësi i listës së shpallur të zgjedhësve, duke i derdhur drejt përedrejti në llogarinë e kësaj organizata politike, përkatësisht të paraqitësi të listës së shpallur të zgjedhësve.

Neni 11

Nuk lejohet marrja e ndihmës materiale dhe finanziare nga shtetet, organizatat dhe personat e huaj.

Nuk lejohet që me anë të presionit të grumbullohen kontribute pér financmin e propagandës elektorale.

Nuk lejohet të grumbullohen as të kërkohrn kontribute në vendet e punës në organet, ndërmarrjet dhe institucionet shtetërore.

Neni 12

Nuk lejohet dhënia as marrja e kontributit nga një person në vlerë më të madhe se 100.000 dinarë brenda një viti kalendarik.

Nuk lejohet që çfarëdo personi t'i japë kontribut organzatës politike, përkatsishtë paraqitësit të listës së shpallur të zgjedhësve në emër të ndonjë personi tjetër, as që këta të marrin kontributin e këtillë.

Neni 13

Organizatat politike, përkatësish paraqitësit e listave të shpallura të zgjedhësve janë të detyruar që Komisionit t'i paraqesin raport për të ardhurat dhe shpenzimet e propagandës elektorale, sipas mënyrës dhe formës të cilën Komisioni do ta cakojë me udhëzimet dhe direktivat e veta.

Neni 14

Secila organizatë politike, përkatësish secili paraqitës i listës së shpallur të zgjedhësve do të caktojë personin, përkatësish zëvendësin e tij/saj që do të jetë përgjegjës për paraqitjen e raportit dhe për mbajtjen e evidencave sipas këtij ligji dhe do të jetë i autorizuar për t'i pranuar kërkesat e Komisionit, për çka do ta njoftojë Komisionin brenda tri ditëve nga emërimi i tij/saj.

Secila organizatë politike, përkatësish secili paraqitës i listës së shpallur të zgjedhësve duhet ta njoftojë brenda tri ditëve Komisionin për çfarëdo ndryshimesh në lidhje me personin nga paragrafi 1 i këtij nenit dhe/ose me personat që e zevendësojnë.

Neni 15

Me këtë ligj është parashikuar që i tërë aktiviteti financier i oreganizatave politike, përkatësish i paraqitësve të listave të shpalluara të zgjedhësve të rregullohet në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Po qe se një gjë e tillë nuk përjashtohet shprehimisht në bazë të dispozitave të këtij ligji, përkatësish në bazë të dispozitave ose të vendimeve të Komisionit, për secilin transaksion financier në të cilin merr pjesë cilido person apo cilëtdo persona, e i cili në çfarëdo mënyre ndikon në aktivitetin politik ose administrativ të organizatës politike, përkatësish të paraqitësít të listës së shpallur të zgjedhësve, duhet të paraqitet raport në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 16

Personi i autorizuar nga Neni 14 i këtij ligji është i detyruar që raportet për derdhjet dhe pagesat e mjeteve financiare t'i nënshkruajë dhe t'i vërtetojë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Neni 17

Raporti nga neni paraprak i këtij ligji për periudhën prej 1 janarit deri me 31 dhjetor të vitit paraprak i paraqitet Komisionit, jo më vonë se deri në fund të shkurtit të vitit vijues.

Në vitin në të cilin mbahen zgjedhjet, përvèç raportit nga paragrafi 1 i këtij neni, paraqiten edhe rapportet vijuese:

- 1) rapporti për periudhën prej janarit deri dhjetë ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve – jo më vonë se pesë ditë para ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve;
- 2) rapporti për periudhën prej 10 ditë para deri 20 ditë pas zgjedhjeve – jo më vonë se 25 ditë pas ditës së caktuar për mbajtjen e zgjedhjeve dhe
- 3) rapporti për periudhën prej 21 ditë pas zgjedhjeve deri në fund të vitit – jo më vonë se deri më 20 janar të vitit të ardhshëm.

Paraqitësi i listës së shpallur të zgjedhësve, i cili nuk është i regjistruar si organizatë politike, do të paraqesë reportin e vet përfundimtar pas përfundimit të aktiviteteve të veta financiare dhe do të lirohet nga paraqitura e mëtejme e raporteve, përpos në rast se Komisioni konstaton të meta në reportin e këtillë përfundimtarë të këtillë.

Po qe se Komisioni gjen të meta në reportin nga paragrafi 3 i këtij neni, ai brenda 10 ditëve nga paraqitura e rapportit do ta paralajmërojë paraqitësin e rapportit për të metat e konstataura, kurse paraqitësi është i detyruar për t'i korriguar të metat e lartpërmendura dhe reportin e këtillë t'ia përcjellë Komisionit, brenda 30 ditëve nga dita pasi të jetë paralajmëruar për të metat e konstataura.

Neni 18

Raporti nga Neni 17 i këtij ligji përbman:

- 1) shumën e mjeteve në para të gatshme në fillim dhe në fund të periudhës së rapportimit;
- 2) për periudhën e rapportimit-edhe vitin kalendarik, shumën e përgjithshme të të gjitha derdhjeve dhe shumën e përgjithshme të të gjitha derdhjeve sipas kategorive vijuese: kuotat e anëtarësisë; kontributet; të ardhurat nga burimet vetjake dhe nga veprimtaritë sipërmarrëse; kreditë; huat; dhuratat; legatat; trashëgimitë; mjetet e kthyera, refundimet dhe kompensimet e tjera në lidhje me shpenzimet operative; finacimi nga shteti dhe burimet e tjera, të cilat Komisioni i cakton dhe i identifikon;
- 3) për periudhën e rapportimit-edhe vitin kalendarik, shumën e përgjithshme të të gjitha pagesave si dhe shumën e përgjithshme të pagesave sipas kategorive vijuese: shpenzimet e drjetpërdrejta të propagandës politike; shpenzimet operative; shpenzimet në lidhje me aktivitetin sipërmarrës dhe shpenzimet e tjera të cilat Komisioni i cakton dhe i identifikon.

Komisioni është i autorizuar për të bërë plotësimin, përkatësisht ndarjen e mëtejme të kategorive nga paragrafi 1 i këtij neni dhe për të saktësuar në ndonjë mënyrë tjetër formën, mënyrën dhe detajet e raportimit.

Neni 19

Për mjetet e derdhura që tejkalojnë shumën 1000 dinarë (në shumën aggregate) ose për kontributet në sende, vlera e të cilave tejkalon 1000 dinarë (në shumën aggregate), do të shënohet shuma e saktë, data e derdhjes dhe adresa e personit, përkatësisht e burimit të derdhjes së këtillë.

Për pagesat që tejkalojnë shumën 1000 dinarë (në shumën aggregate), do të shënohet shuma e saktë, data e pagesës dhe adresa e personit të cilit i janë paguar mjetet.

Në raport do të shënohet shuma dhe lloji i borxheve dhe detyrimeve të pashlyera nga organizata politike, përkatësisht ndaj organizatës politike dhe, po qe se këto borxhe dhe detyrime janë shlyer në shumën që është më e vogël se shuma, përkatësisht se vlera e shënuar në report, duhet të shënohet edhe deklarata për rrethanat dhe kushtet në të cilat janë shlyer këto borxhe ose detyrime.

Komisioni është i autorizuar për të bërë plotësimin, përkatësisht ndarjen e mëtejme të kategorive sipas këtij neni dhe për të saktësuar në ndonjë mënyrë tjetër formën, mënyrën dhe detajet e raportimit.

Neni 20

Raportet nga Neni 17 i këtij ligji mund të dërgohen edhe në formë digitale.

Në qoftë se raportet dërgohen sipas mënyrës nga paragrafi 1 i këtij neni, Komisioni do të caktojë mënyrën e verifikimit të tyre.

Neni 21

Komisioni cakton rregullat dhe normativat për zbatimin e këtij ligji, si dhe udhëzimet e hollësishme për përbajtjen e raporteve, për mënyrën e raportimit, formularët dhe udhëzimet e tjera.

Komisioni do të përpilojë formularët dhe doracakët e nevojshëm për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, që kanë të bëjnë me raportimin dhe do t'u sigurojë stërvitje dhe/ose ndihmë organizatave politike, për t'u ndihmuar atyre për t'i përbushur kërkesat që u parashtrohen.

Gjatë përbushjes së detyrave të veta sipas këtij ligji, Komisioni mund të shfrytëzojë ndihmën e të gjitha organeve dhe organizatave shtetërore, të cilat janë të obliguara për ta dhënë këtë ndihmë në masën e mundshme maksimale.

Neni 22

Raportet e dërguara Komisioni do t'ia vëjë në dispozicion opinionit brenda 24 orëve pasi t'i ketë marrë dhe do të bëjë të mundshme që të dhënrat që përbahen në raporte t'u vihen në dispozicion qytetarëve.

Neni 23

Për parregullsitë e konstatuara në veprimtarinë finaciare të organizatave politike, përkatësisht të paraqitésve të listave të shpallura të zgjedhësve dhe pér mënyrën e veprimit të organizatave politike, përkatësisht të paraqitésve të listave të shpallura të zgjedhësve që janë në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, Komisioni është i detyruar pér t'i njoftuar organet kompetente me qëllim të ngritjes eventuale të procedurës kundërvajtëse, përkatësisht të procedurës penale.

Neni 24

Me gjobë në shumën prej pesëdhjetëfishit deri në dyqindfishin e pagës minimale në Republikë do të dënohet pér kundërvajtje organizata politike, përkatësisht paraqitësi i listës së shpallur të zgjedhësve:

- 1) në qoftë se mjetet i fiton në kundërshtim me dispozitën e Nenit 3 të këtij ligji;
- 2) në qoftë se nuk mban evidencë pér veprimtarinë finanziare në përputhje me dispozitën e Nenit 4 të këtij ligji;
- 3) në qoftë se merr ndihmë materiale dhe finanziare në kundërshtim me dispozitat e neneve 11 dhe 12 të këtij ligji;
- 4) në qoftë se grumbullon kontribute në kundërshtim me dispozitën e Nenit 10 të këtij ligji;
- 5) në qoftë se nuk dërgon raporte sipas mënyrës dhe brenda afateve të parashikuara me dispozitat e këtij ligji.

Për kundërvajtjen nga paragrafi 1, pikat 1, 3 dhe 4 të këtij neni do të konfiskohet levërdia pasurore e fituar me anë të kundërvajtjes.

Me gjobë në shumën prej dyfishit deri në dhjetëfishin e pagës minimale në Republikë do të dënohet pér kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij neni edhe personi përgjegjës në organizatën politike, përkatësisht te paraqitësi i listës së shpalluar të zgjedhësve.

Neni 25

Me gjobë në shumën prej dyfishit deri në pesëmbëdhjetëfishin e pagës minimale në Republikë do të dënohet pér kundërvajtje personi:

- 1) i cili grumbullon mjete në kundërshtim me dispozitën e Nenit 10 të këtij ligji;

2) i cili jep kontributin në kundërshtim me dispozitën e Nenit 12 të këtij ligji.

Për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij nenit do të konfiskohet levërdia pasurore e fituar me anë të kundërvajtjes.

Neni 26

Me gjobë në shumën prej pesëdhjetëfishit deri në treqindfishin e pagës minimale në Republikë do të dënohet për kundërvajtje organizata politike, përkatësisht paraqitësi i listës së shpallur të zgjedhësve, në qoftë se tejkalon shumën e shpenzimeve të propagandës elektorale të përcaktuar me dispozitën e Nenit 9, paragrafi 1, të këtij ligji.

Me gjobë në shumën prej pesëfishit deri në njëzetfishin e pagës minimale në Republikë do të dënohet për kundërvajtjen nga paragrafi 1 i këtij nenit edhe personi përgjegjës në organizatën politike, përkatësisht te paraqitësin i listës së shpallur të zgjedhësve.

Neni 27

Komisioni do të nxjerrë dispozita për zbatimin e këtij ligji brenda 60 ditëve nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 28

Ditën e hyrjes së këtij ligji në fuqi shfuqizohet Ligji për financimin e partive politike („Gazeta Zyrta e RMZ“, nr.44/97).

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi tetë ditë pas datës së botimit në „Gazeten Zyrta e Republikës së Malit të Zi“.

Neni 30

Përkufizimet

Me shprehjen „kontribut“ kuptohet çfarëdo dhurate, kuotizacion anëtarësie, huaje, paradhënieje, përkatësisht depozitimi i parave ose i çfarëdo sendi me vlerë nga ana e çfarëdo personi me qellim të ndikimit në zgjedhjet përfunksion publik në Republikën e Malit të Zi, përkatësisht pagimi i shpërblimit nga ana e çfarëdo personi për shërbime personale të personit tjetër që kandidatit, përkatësisht organizatës politike i janë dhënë falas për çfarëdo qëllimi.

Shprehja „kontribut“ përfshin: (a) vlerën e shërbimeve të dhëna pa shpërblim nga cilido individ i cili angazhohet vullnetarisht në favor të

kandidatit, përkatësish të organizatës politike dhe (b) aktivitetin jopartiak që ka për qëllim nxitjen e individëve për të votuar, përkatësish të regjistruar në registrat e zgjedhësve.

Shprehja „shpenzime“ përfshin çfarëdo blerjeje, pagese, shpërndarjeje, huaje, paradhënieje, depoziti, përkatësish dhurate në para ose në çfarëdo vlerë nga ana e cilitdo person me qëllim të ndikimit në cilatdo zgjedhje, si dhe kontrata, premtimi, përkatësish pëlqimi se do të mbulohen shpenzimet.

Shprehja „shpenzime“ nuk përfshin shpenzimet në lidhje me: (a) çfarëdo teksti, komenti ose kryeartikulli të gazetarisë që është shpërndarë me anë të mjeteve të cilidlo stacion radio-televiziv, të gazetës, revistës ose publikimit tjetër periodik, përvèç nëse këto mjete të informimit janë në pronësinë ose nën kontrollin e organizatës politike, përkatësish të kandidatit, gjegjësisht (b) aktivitetin jopartiak që ka për qëllim nxitjen e individëve për të votuar, përkatësish të regjistruar në registrat e zgjedhësve.

Shprehja „person“ përfshin cilindo individ, partner, këshill, shoqatë, shoqëri aksionare, organizatë punuese, përkatësish cilëndo organizatë tjetër ose grup personash.


Shprehja „identifikim“ do të thotë: (a) kur është fjalë për cilindo individ – emrin, adresën dhe profesionin e këtij individi, si dhe emrin e punëdhënësit të tij/saj, dhe (b) kur është fjalë për cilindo person tjetër – emërtimin e plotë dhe adresën e këtij personi.

Shprehja „organizatë politike“ përdorur në këtë ligj ka të njëjtën domethënie sikurse në Ligjin për organizatat politike.

Shprehja „kontributi në mjete“ do të thotë: çfarëdo sendi me vlerë që i sigurohet organizatës politike, me përjashtim të pagimit të drejtpërdrejtë të parave dhe që nuk është përjashtuar shprehimi i përkufizimi i „kontributit“ në paragrafi 2 të këtij nenit..

Shprehja „raport“, kur është fjalë për Komisionin, nënkuption raportin, vendimin e emërimit, përkatësish deklaratën që i dërgohet Komisionit në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

Shprehja „paraqitës i listës së shpallur të zgjedhësve“ nënkuption grupin e qytetarëve që është kualifikuar përfletëvotim në listën e zgjedhësve, në përputhje me dispozitat e Ligjit për zgjedhjen e këshilltarëve dhe të deputetëve.



Country Montenegro
Year 1999 Language Albanian
Description Model laws for the Election
of Councillors and Representatives
and Political Party financing

IFES developed/sponsored? YES